



AGJENSIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
DEPARATMENTI I ENERGJIVE TE RINOVUESHME

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më

2007

Strategjia sektoriale e energjisë 2006-2020

PËRMBLEDHJE

PASQYRA E LËNDËS

Pasqyra e lëndës	2
Tabela dhe figura	3
Hyrje	4
1. Situata aktuale e sektorit te energjise	7
1.1 Problemet e Strategjise te Vitit 2003 dhe Strategjia E Perditsuar	
1.2 Furnizimi me burime primare kombetare	9
1.3 Tarifat	13
1.4 Rezervat	14
1.5 Organizimi i sektorit	15
1.6 Situata e sektorit energjetik ne rajon	18
2. Vizioni, prioritetet dhe qëllimet strategjike	20
3. Politikat	21
3.1 Ristrukturimi i sektorit energjetik shqiptar dhe Krijimi i nje kuadri efektiv	24
3.2 Nxitja e perdorimit eficient te energjise	28
3.3 Optimizimi i sistemit te furnizimit dhe Rritja e sigurise se furnizimit me burime energjetike ...	28
3.4 Nxitja e perdorimit te burimeve te rinovueshme te energjise	35
3.5 Hapja e tregut te energjise elektrike	36
4. Implikimet per burimet	41
5. Llogaridhënia	45
5.1 Konsultimi	45
5.2 Monitorimi	45

TABELA DHE FIGURA

Tabela 1. Humbjet ne Sistemin e Energjise Elekrike (GWh) 2001-2005

Tabela2: Investimet e kerkuara per zbatimin e skenarit aktiv ne sektorin elektrik

Tabela 3: Investimet e kerkuara per zbatimin e skenarit aktiv ne sektorin naftes

Tabela4: Investimet e kerkuara per zbatimin e skenarit aktiv ne sektorin Rafinerise dhe terminale

Tabela 5 Investime ne lidhjen me rrjetin e gazit natyror

Tabela 6. Investimet e parashikuara per energjite e rinovueshme sipas skenarit Aktiv

Tabela 7: Investimet e kerkuara per zbatimin e masave te eficiences se energjise ne te gjithe sektoret ekonomik dhe shoqeror

Tabela 8 Raporti i investimeve

Fig.1: Konsumi i burimeve energjetike sipas çdo sektori

Fig 2: Konsumi i energjise elektrike sipas çdo sektori (GWh)

Fig. 3: Humbjet ne Sistemin e Energjise Elekrike(GWh) 2001-2005

Fig.4: Prodhimi kumulativ i naftes sipas vendburimeve.

Fig 5.: Totali i kursimeve nga implementimi i masave te eficiences ne te gjithe sektoret [ktoe]

Fig. 6 Tarifat e energjise elektrike sipas strgj vjeter

Fig. 7 Tarifat e en. elektr ne Startegjine e perditesuar [cent/kWh] [cent/kWh]

SHKURTIME TË PËRDORURA NË STRATEGJI

METE	Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes
A.K.E.	Agjensia Kombëtare e Energjisë
A.K.B N.	Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore
ANE	Agjensia Ndërkombëtare e Energjisë
ARMO	Albanian Refining and Marketing of Oil (Shoqëria Anonime Publike e Përpunim Marketingut).
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
BB	Banka Botërore.
BE	Bashkimi Evropian
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (Organization for Economic Co-operation and Development)
OPEC	Organizata e Vëndeve Eksportuese të Naftës (Organization of Petroleum Exporting Countries).
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar.
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
OST	Operatori i Sistemit te Transmetimit
OSSH	Operatorit te Sistemit te Shperndarjes
IQT	Inspektoriti Qendror Teknik
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
EURO (€)	Monedha Evropiane
f (b)	fuçi (1 fuçi amerikane = 0,14 ton metrik)
f/d (b/d)	fuçi për një ditë.
F.M.N.	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GDP	Prodhimi Brëndshëm Brut (Gross Domestic Production).
GLN (LPG.)	Gaz i Lëngët i Naftës
GN (NG)	Gaz Natyror (1 m ³ gaz natyror = 1 kg naftë brut = 10000kkal = 41 860 kJ (kiloxhaul))
GNL (LNG)	Gaz Natyror i Lëngëzuar.(1m ³ G.N.L. = 600m ³ gaz)

FK.	Fuqia Kalorifike
IQT.	Inspektoriati Qendror Teknik
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
KE	Komisioni Evropian
kal	Kalori
Kkal	Kilokalori
kW	kilovat (1 vat x 1 000)
kWh	kilovat-orë
l	Litër
Mt	miljonë ton
Mtoe	miljonë ton ekuivalent nafte
MW	megavat (1 vat x 10 ⁹)
MWh	megavat-orë
Nm ³	Normal metër kub (njësi matje vëllimi gazi natyror)
PBB	Prodhimi i Brëndshëm Brut (Gross Domestic Production)
ppm	Pjesë për milionë. (Parts per million). Përdoret kryesisht për të përcaktuar sasinë e metaleve ose papastërtive të tjera në produktet e rafinuara të naftës.
Bcm	biljonë (miljardë) metra kub (m ³)
CO	Monoksid karboni
CO ₂	Dioksid karboni (Gaz karbonik)
SO ₂	dioksid squfuri
toe	Ton ekuivalent naftë (ton oil equivalent) 10 ⁷
tonne	ton metrik (1 ton metrik i naftës brut = 7,3 fuçi)
TW	teravat (1 vat x 10 ¹²)
TWh	teravat-orë.
US\$	Dollar Amerikan. Monedha e SH.B.A.

HYRJE

Perditesimi i “Strategjise Kombetare te Energjise” per periudhen 2007-2020 eshte jo vetem ne mbeshtetje te VKM-se Nr. 424, date 26.06.2003 “Per Miratimin e Strategjise Kombetare te Energjise” deri ne vitin 2015, por eshte edhe nje kerkese e percaktuar nga angazhimet qe ka marre Qeveria ne kuadrin e Marreveshjes se Stabilizim - Asocimit, nga zhvillimet e fundit te sektorit te energjise sipas direktivave per Sektorin e Energjise te BE-se si dhe detyrimet qe dalin nga Traktati i Komunitetit te Energjise te Vendeve te Europes Juglindore i ratifikuar me ligjin Nr.9501 date 03.04.2006. Ne keto kushte, duke marre ne konsiderate se ndryshimet ne sektorin energjetik nuk do te ndodhin spontanisht nepermjet urdhrimit te Kryeministrit Nr.133, date 08.06.2006 per *“Ngritjen e Grupit te Punes Nderinstitutional per Perditesimin e Strategjise Kombetare te Energjise per periudhen deri ne 2020”* u realizua perditesimi i Strategjise Kombetare te Energjise.

Eksperienca nga vendet e zhvilluara ka treguar se, per te patur nje zhvillim normal te sektorit energjetik duhet te vendoset nje balance e drejte si ndermjet mekanizmave te tregut dhe nderhyrjeve te Qeverise, ashtu edhe ndermjet aspekteve teknike/teknologjike dhe menaxhimit te energjise.

Strategjia Kombetare e Energjise, e perditesuar, do te jete ne thelb nje shprehje e nevojave kombetare, e cila do te siguroje rruget per nje zhvillim te qendrueshem te mbare ekonomise, duke percaktuar te gjitha objektivat si dhe masat e nevojshme ne aspektin institucional, ekonomik, teknologjik, fiskal, etj. ne mbeshtetje te sektorit energjetik. Strategjia permban nje teresi masash te percaktuara per sektorin e energjise dhe evidenton investimet perkatese ne vlere dhe kohen e domosdoshme qe duhet per t’i realizuar ato.

Domosdoshmeria e ketij dokumenti te rendesishem lidhet edhe me problemet dhe sfidat e mprehta energjetike me te cilat eshte ballafaquar dhe pritet te ballafaqohet vendi yne. Shqiperia paraqitet nje vend me nje konsum energjie shume te ulet per banore dhe me nje intensitet te larte energjie si rezultat i teknologjive te vjetra qe perdor ne shume dege te ekonomise si dhe paisjeve te standarteve jo bashkohore qe perdoren ne sektorin e banesave dhe te sherbimeve. Problemet e furnizimit me burime energjetike kane ndikuar ne nivelet e ulta te aktivitetit ekonomik si dhe ne nivele modeste te komfortit te jeteses.

Ne kete kontekst, ky dokument do te perfshije te gjitha hapesiren e zhvillimit te sektorit energjetik, duke filluar nga kerkesa, rezervat, opsionet e furnizimit deri edhe tek sjellja e konsumatoreve. Synimi thelbesor i zhvillimit te sektorit energjetik do te jete garantimi i nje furnizimi te sigurt me energji per te mbeshtetur nje zhvillim te qendrueshem ekonomik te vendit.

Sfida e kesaj Strategjie do te jete:

Orientimi i zhvillimeve te sektorit energjetik sipas skenareve me optimale, qe do te shoqerohen me politika dhe veprime aktive te studiuara te te gjitha lojtareve per çdo dege. Zhvillimi sipas skenareve te tille do te mundesoje nje permiresim te shpejte, te sigurt dhe me kosto minimale te furnizimit me burime energjetike te ekonomise se vendit duke ruajtur normat e Bashkimit Europian per mjedisin.

1. Situata aktuale e sektorit te energjise dhe sfidat

Konsumi i burimeve energjetike per te gjithe sektoret e ekonomise ne vendin tone ka pesuar nje rritje nga viti ne vit, perjashtim ne kete ecuri ka bere periudha 1990-1992, ne te cilen renia e konsumit arriti nga 2.26 Mtoe per vitin 1990 ne 1.22 Mtoe per 1992, si pasoje e mbylljes se shume konsumatoreve industriale. Me pas, situata ne Shqiperi ndryshoi ne menyre rrenjesore, intensiteti i energjise u reduktua me afersisht 50%, megjithese konsumi per fryme i energjise eshte akoma ne nivele te ulta. Ne vitin 2005, ne lidhje me keta dy tregues, kemi nje rritje te konsumit energjetik per banore me 11.7% dhe nje rritje te vogel te intensitetit energjetik me 2,3%. Konsumi me burime energjetike ne kete vit eshte ne vleren 1.996 Mtoe, siç shihet dhe ne Figuren 1. Ndersa ne figuren 2 eshte dhene konsumi i energjise elektrike sipas sektoreve te ekonomise. Per vitin 2005 theksojme qe sektori rezidencial ka patur peshen kryesore ne konsumin e energjise elektrike me 54%, i dyti vjen sektori i sherbimeve me 23 %, i treti eshte sektori i industrise me 18 % dhe me pas vjen bujqesia me 6 %.




Fig.1: Konsumi i burimeve energjetike sipas çdo sektori (ktoe)




Fig 2: Konsumi i energjise elektrike sipas çdo sektori (GWh)

Duhet te theksojme pas vitit 2000 u vu re renia e konsumit te energjise elektrike jo se degjet e ekonomise pesuan renie konsumi, por se sistemi elektroenergjetik nuk ishte ne gjendje te realizonte furnizimin e shume konsumatoreve. Kjo beri qe disa ndermarrje dhe sektore sherbimesh te instalonin gjeneratoret rezerve te energjise elektrike.

Sektori qe ka njohur rritje te vazhdueshme te konsumit te lendeve energjetike eshte sektori i transportit. Ne vitin 1990 ai kontribuonte me 6% te totalit te energjise ndersa ne vitin 2005 ky sektor ze nje peshe 44.3%, sektori i banesave me 26.5%, sektori industrial 12.4%, sektori i sherbimeve 10.4% dhe bujqesia 4.5%.

Eshte e rëndësishme te theksohet se produktet e naftes e kane rritur peshen e tyre ne konsumin final te energjise nga 48% ne 1995 ne 63.1% ne 2005. Kjo ka ndodhur per shkak se konsumi i druve te zjarrit, qymyrit dhe gazit natyror ka rritur dhe zhvillimi i sektorit te transportit çoi ne rritje te madhe te konsumit te nenprodukteve te naftes (dizel dhe benzine). Norma mesatare vjetore e rritjes se konsumit te nenprodukteve te naftes gjate kesaj periudhe eshte me 6.2%, nderkohe qe sektori i transportit regjistroi nje norme rritjeje me 8.8% dhe sektori i sherbimeve me 9.1%.

Referuar konsumit final sipas sektoreve te nenprodukteve te naftes per vitin 2005, veme re se sektori i transportit eshte mjaft i rendesishem, duke konsumuar rreth 55%, bujqesia dhe peshkimi 16%, industria 13%, sherbimi 6,6%, banesat 7,04%. Pavaresisht nga ritmet e rritjes se sektoreve, peshen kryesore ne konsumin e nenprodukteve te naftes e mbajne sektori i transportit, bujqesise dhe ai i industrise. Ne bilancin e konsumit te nenprodukteve te naftes, diezeli rezulton si karburanti kryesor me rreth 55% te konsumit perfundimtar te produkteve te naftes dhe me pas vjen benzina me 13%.

1.1 Problemet e Strategjise te Vitit 2003 dhe Strategjia E Perditsuar

Pavarsisht se Strategjia e vitit 2003 vuri detyra per permiresimin dhe stabilizimin e situates energjitike, problemet kyce te sektorit te energjise nuk gjeten zgjidhje duke patur ndikim ne situata problematike energjitike gjate periudhes 2003-2006 si pasoje e mos zbatimit te skenarit aktiv. Disa nga keto probleme po i rendisim si me poshte:

- *Kapaciteti i sotem gjenerues* eshte i pamjaftueshem per te perballuar kerkesen e sotme. Per pasoje energjia elektrike vazhdon t'i jepet konsumatoreve pjeserisht. Investimi i planifikuar per ndertimin e TEC-it te Vlores nuk u krye.
- *Problemi i "humbjeve jo teknike"*: qe do te thote energji elektrike e marre nga rrjeti nepermjet lidhjeve ilegale ose energji elektrike e papaguar, vazhdon te jete ne nivele te larta si rezultat i moszbatimit te masave te programuara per reduktimin e tyre.
- *Humbjet teknike ne rrjetin e transmetim shperndarjes* vazhdojne te jene ne nivele te larta 25.5 % si rezultat i moszbatimit te masave te programuara per reduktimin e tyre.
- *Interkonjeksioni elektrik me vendet e tjera fqinje*: vazhdon problemi i kufizimeve te linjave te interkonjeksionit ne sistemin Grek, qe redukton ndjeshem kapacitetin tone importues. Linja 400 kV Elbasan-Podgorice, percaktuar per t'u ndertuar ne vitin 2005 nuk eshte realizuar.
- *Konsum shume i larte i energjise elektrike per ngrohje*: Vazhdon tendenca ne drejtim te rritjes se konsumit te energjise elektrike per ngrohje edhe pse ne disa raste ekzistojne mundesi te perdorimit te burimeve alternative energjitike.
- Mos liberalizimi i cmimeve te energjise elektrike vazhdon te kete ndikim ne perdorim masiv te energjise elektrike sidomos ne sektoret e banesave ate te sherbimeve. Dhe pse jane marre masa sunvensionuese nga Qeveria, mos kontrolli i plote i matjes se energjise elektrike ka ndikim te drejt per drejte ne perdorimin e larte te saj.
- Eficence e ulet ne perdorimin e energjise.
- Vazhdimi i mos zbatimit te ligjit "Per Ruajtjen e Nxehtesise ne Ndertesa" se bashku me Rregulloren Teknike per Ngrohjen e Ndertesa Private dhe publike me lende djegese organike dhe jo me energji elektrike, qe tashme jane ne fuqi.
- Vazhdon struktura e furnizimit me burime primare energjitike te jete pak e diversifikuar, ku vazhdon kontributi gjithnje e me i madh i burimeve te tilla si nafta, hidroenergjia dhe drute e zjarrit perkundrejt qymyrit dhe gazit natyror te cilet jane ne nivele minimale.
- Vazhdon penetrimi dhe organizimi jo ne shkallen e duhur te LPG, per te siguruar ngrohjen dhe gatimin,
- Vazhdon penetrimi jo ne shkalle te mjaftueshme te sistemeve te paneleve diellore, per sigurimin e ujit te ngrohte,
- Vazhdon menaxhimi jo i mire te energjise ne sektorin sherbimeve publike (ngrohje, gatim, pergatitje ujit te ngrohte, ndricim, paisje elektrike dhe kondicionim te ajrit),

Per sa mesiper si dhe nisur nga vazhdimi i situates problematike te sektorit te energjise ku detyrat e Strategjise se vitit 2003 pothuajse kane ngelur te pa realizuar, si dhe nga angazhimet qe ka marre Qeveria jone ne kuadrin e Marreveshjes se Stabilizim - Asocimit si dhe Traktati i Komunitetit te Energjise te Rajonit u ndermuarre perditesimi i Strategjise Kombetare te Energjise deri ne vitin 2020. Vlen te përmendim hapat e duhuara qe po hedh aktualisht sistemi energjitik shqiptare ne drejtim te stabilizimit te tij, ku disa prej tyre po i rendisim si me poshte:

- Permiresimin ne fushen e legjislacionit per zhvillimin e investimeve ne sektorin e energjise mbështetur ne asistencen dhe pervojën e huaj. Ne kete kuadër nje ndihmese te madhe po

jep "Ligji i Koncesioneve" Nr. 9663, date 18.12.2006, dhe VKM Nr.27 date.19.01.2007 "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenjes me koncesion", ku përcaktohen procedurat dhe dokumentacioni qe do te plotësohet per realizimin e nje koncesioni.

Reforma ne ndarjen e kompanise vertikalisht te integruar KESH sh.a. lidhur me pershpejtimin e ndarjes se plote te sektorit te gjenerimit, shperndarjes dhe transmetimit.

Shoqeria KESH sh.a. realizoi ndarjen e llogarive financiare te shoqerise se re OST sh.a.

Per OSSH (Operatori i Sistemit te Shperndarjes) eshte krijuar me VKM Nr. 862, date 20.12.2006 "Per krijimin e shoqerise "Operatori i Sistemit te Shperndarjes" sh.a. Tirane", ku jane përcaktuar kriteret per krijimin e OSSH -se dhe eshte ne proces ndertimi i strukturave drejtuese. Ne te njejten kohe po punohet dhe per privatizimin e veprimtarise se sektorit te shperndarjes se energjise elektrike.

Per sektorin e Gjenerimit eshte hartuar projekt ligji per privatizimin e tij. Ne kete kuadër kane filluar procedurat per miratimin e e ketij projekt ligji.

Politika aktuale zhvilluese per privatizimin e plote te sektorit Hidrokarbur

Si dhe hapat ligjore te ndërmarra per përdorimin e ne standarde evropiane te cilesise se produkteve te naftes dhe te gazit

Te gjitha keto hapa te ndërmarra, perbejne angazhimin serioz te qeverise shqiptare përkundrejt obligimeve me direktivat e Bashkimit European, MSA-ne dhe Traktatin e Energjise. Sidoqofte nje detyre e rendesishme e kesaj Strategjije do te jete zbatimi rigoroz i masave te paralizuara te Strategjise se vitit 2003 ku gjashte masat e para jane mjaft te rendesishme dhe energjente per te nxjerre vendin tone nga kriza energjitike.

1.2 Furnizimi me Burime Primare Kombetare

Ne konsumin energjetik sipas burimeve, per vitin 2005 vlen te përmendim qe hidrokarburet kane dominimin kryesor me 1269 ktoe, dhe me pas vjen energjia elektrike 551.7 ktoe dhe drute e zjarrit me 235 ktoe. Pavaresisht se situata e furnizimit me produkte primare vjen gjithmone ne rritje, tregu i vendit tone ka mbetur deficitar ne furnizimin me energji elektrike, me hidrokarbure dhe i pa lidhur me rrjetin nderkombetar te gazit natyror.

Energjia elektrike

Furnizimi me energji elektrike

Prodhimi i energjise elektrike nga ana e hidroenergjise ka njohur rritje vitet e fundit dhe kjo i dedikohet me shume viteve te lageshta. Por nga ana tjeter per shkak te rritjes se kerkeses eshte rritur ndjeshem edhe importi i energjise elektrike dhe kjo situata pritet te vazhdoje edhe ne te ardhmen deri ne ndertimin e centraleve te reja te prodhimit te energjise elektrike. Disa nga problemet qe jane hasur ne furnizimin me energji elektrike jane:

- Kapaciteti gjenerues disponibel eshte i pamjaftueshem per te plotesuar kerkesen ne rritje te energjise elektrike ne vend edhe kur kushtet hidrologjike jane te favorshme;
- Sigurimi i importit nga vendet e rajonit si dhe sigurimi i kapaciteteve te interkonjeksionit per te transmetuar kete energji deri ne kufirin shqiptar. Siç do te analizohet dhe ne seksionin e situates rajonale, me mbylljen e TEC-it berthamor ne Bullgari situata ne rajon ne lidhje me sigurimin e energjise elektrike te importit eshte perkeqesuar dhe ajo qe eshte shume me e rendesishme eshte se çmimet e energjise elektrike te importit po arrijne nivele shume te larte.

- Problemi me i rendesishem, ne lidhje me gjenerimin e energjise elektrike eshte se pothuajse 99% e saj prodhohet nga HEC-et duke qene keshtu prezent risku i furnizimit te vazhdueshem me energji elektrike.
- Rritja e kerkeses per energji elektrike eshte me e larte se per çdo burim tjetër energjie megjithese furnizimi neto me energji elektrike eshte rritur me me shume se 8.9 % ne vit qe nga viti 1990. Ky mbi-konsum i energjise elektrike sidomos ne nivel tensioni te ulet ka çuar ne humbje shume te medha teknike ne rrjetin e transmetimit dhe shperndarjes per shkak te mbingarkeses ose demeve te tjera qe i jane bere KESH-it. Kjo rritje kerkese po kapercen rritjen e faturimit te shitjeve te energjise elektrike per shkak te nje niveli ne rritje te humbjeve jo-teknike. Ky “fenomen” praktikisht ka shperthyer qe nga 1991-1992 ne formen e konsumit nepermjet lidhjeve ilegale. Vlera e konsumit qe nuk matet vleresohet te jete ne nje nivel shume te larte krahasuar me konsumin faktik. Llogaritjet tregojne se vlera totale e humbjeve eshte rreth 40 %, vlere e cila ruhet qe prej vitit 2003. Kjo do te thote se sa here qe KESH-i prodhon 1 kilovat-ore, kompania eshte ne gjendje te arketoje rreth 0,6 kilovat-ore.

Humbjet

Per vitin 2006, humbjet teknike ne rrjetin e shperndarjes llogariten te jene me teper se 1073 GWh/vit ne vitin (mbi 18% e energjise elektrike te hedhur ne rrjet humbet). Humbjet ne rrjetin e transmetimit jane llogaritur te jene afersisht 256 GWh/vit (mbi 6%) ndersa humbjet jo teknike jane 930 GWh/vit ose 16.4 %. Figura 3 paraqet humbjet ne sistemin e energjise elektrike per vitet 2001-2006.




Fig. 3: Humbjet ne Sistemin e Energjise Elektrike(GWh) 2001-2005

GWh	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Humbjet ne Trans. Dhe Shpernd	2500	2375	2367	2330	2281	2259
Humbjet Teknike ne Transmetim.	340	335	330	338	266	256
Humbjet Teknike ne Shperndarje.	1060	1070	1066	1067	1079	1073
Humbjet jo Teknike ne Shperndarje	1100	970	971	925	936	930

Tabela 1. Humbjet ne Sistemin e Energjise Elektrike (GWh) 2001-2005

Humbjet teknike ne rrjetin e transmetim-shperndarjes ne vitin 2001 kane qene 1400 GWh (340 GWh ne transmetim dhe 1060 GWh ne shperndarje) ose 25.5 % te energjise elektrike te furnizuar (Tabela 1). Po t'i referohemi te dhenave, deri ne vitin 2006, humbjet ne total kane qene

pothuaje kostante, gje qe do te thote se masat e ndermarra per reduktimin humbjeve teknike ne transmetim dhe ne shperndarje deri tani kane rezultuar jo efektive edhe pse ka nje program ambicioz per zvogelimim e humbjeve te KESH-it, te parashikuara ne Planet e Veprimit 2 vjeçare te KESH-it, te miratuara nga Qeveria.

Orientimi i punes ne KESH ne drejtim te forcimit te disiplines komerciale ne njesite shperndarese eshte nje angazhim qe kerkon akoma me shume perpjekje eficiente dhe me shume investime per reduktimin e humbjeve teknike.

Humbjet jo teknike qe do te thote energjia elektrike e marre nga rrjeti nepermjet lidhjeve ilegale ose energji elektrike e papaguar per vitin 2001 ishin 1100 GWh. Ne vitet 2005 dhe 2006 keto humbje dhe pse jane reduktuar ne vleren 930 GWh per shkak te masave te ndermarra nga KESH-i, mbartin akoma nje kosto ekonomike te konsiderushme per arken e KESH-it. Sidoqofte duhet theksuar se per eleminimin e ketyre humbjeve kerkohen masa te menjehershme per nje kontroll mjaft te rrepte te konsumatoreve, te cilat lidhen me rritjen e arketimeve, nderprerjet e lidhjeve jo legale pa lene jashte vemendjes edhe zonat ku jane vendosur matesat e rinj te cilet nga pikpamja e instalimit lene shteg per abuzime, dhe vendosjen e matesave ku ato mungojne. Duke patur parasysh qe koeficienti i performances aktuale te KESH-it eshte 41 %, veme ne dukje se realizimi i masave te mesiperme do te ndikojne ndjeshem ne permiresimin e treguesve financiare te KESH.

Importi

Importi energjise elektrike ne vendin tone eshte i varur se pari nga sigurimi i energjise elektrike nga vendet e rajonit dhe nga aksesit qe lejon linjat ne zonen e Ballkanit. Ky fakt, krijon nje akses te kufizuar te furnizimit me energji elektrike per te perballuar nevojat gjithnje ne ritje te tregut te vendit tone, ne keto kushte ndertimi i linjes Elbasan Podgorice do t'i krijonte frymarjen e duhur ne importin energjise elektrike ne vendin tone.

Nje problem tjetër i mprehte lidhur me importin e energjise elektrike me te cilin po perballlet KESH-i, sidomos ne dy vitet e fundit, jane çmimet gjithmone e me te larta te ketyre importeve. Kjo situatë e ka vene KESH-in ne veshtiresi likuiditetesh te mjaftueshme per te realizuar keto importe.

Duhet theksuar se importi i energjise elektrike eshte veshtiresuar per shkak te rritjes se deficitit te energjise elektrike ne rajonin e Ballkanit ku numri me i madh i vendeve jane importues neto te energjise elektrike (perveç Bullgarise, Rumanise dhe Bosnje Hercegovines te cilat jane eksportues neto te energjise elektrike). Parashikimet e bera nga shume analiste dhe konsulente tregojne se deficitit pritet qe te rritet akoma me shume ne te ardhmen duke patur parasysh jo vetem rritjen e nevojave per energji elektrike ne te gjitha vendet, por edhe mbylljen e TEC-it me energji berthamore te Kozloduse ne Bullgari. Te gjithë keto elemente se bashku do te krijojnë veshtiresi per te gjitha vendet e rajonit lidhur me furnizimin me energji elektrike.

Hidrokarburet

Furnizimi me nafte dhe nenprodukte te saj

Furnizimi i ekonomise me nenprodukte nafte dhe gazi realizohet nga importi dhe prodhimi vendas. Megjithese prodhimi vendas i nenprodukteve te naftes e gazit ploteson rreth 37-38 % te nevojave te ekonomise, ai luan nje rol te rendesishem jo vetem per vendosjen e ekuilibre te drejta ne furnizimin e sektoreve, por dhe per te ndikuar qe luhatjet e çmimeve te mos dalin jashte kontrollit. Ne keto kushte shteti, ka stimuluar vazhdimisht rritjen e prodhimit nga shoqerite "Albpetrol Sha" dhe "ARMO Sha" duke mbeshtetur dhe reformat e marra per rritjen e efektivitetit te tyre.

Vitet e fundit jane marre disa rezultate te pjesshme te arritura nga "Albpetrol Sha", ku me rritjen e investimeve u vune ne pune 464 puse nga fondi i ndalur dhe u bene permiresime ne

infrastruktura e teknologji, u rrit niveli i prodhimit ne 985 ton/dite dhe per vitin 2005 u prodhua 349 116 ton nafte.Me evident jane treguesit e arritur nga kompania Kanadeze “Bankers Ltd” gjate zbatimit te projektit ne zonen e Patos-Marinzes, e cila mbi bazen e investimeve te realizuara, kompletoi me teknologji bashkekohore rreth 90 puse, duke realizuar per vitin 2005 nje prodhim nafte prej 98 425 ton.

Depozitimi i naftes, gazit dhe nenprodukteve me qellim shperndarjen e produkteve apo mbajtjen e Rezerves se Sigurise realizohet nga shoqerite e tregtimit me shumice dhe shoqerite e tregtimit me pakice, te licensuara ne baze te Ligjit nr.8450, date 24.02.1999 “Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre”, si dhe akteve nenligjore te nxjera ne zbatim te tij.

Sektori i rafinerise perballet me veshtiresi te medha si pasoje e teknologjise se vjeter si dhe mungeses se nje sistemi modern per operacionet e punes, per mirembatjen e sistemit te kontrollit etj. Ai gjithashtu ka probleme serioze ne mungesen totale te kontrollit te ndotjeve mjedisore. Cilesia e prodhimit te produkteve eshte problematike dhe jo konkurruese me ato te tregut nderkombetar me perjashtim te diezELIT, vajgurit dhe bitumit te cilet kane nje afersi me keto standarte, kurse produktet e tjera kane karakteristika teknike jo atraktive per konsumatoret.




Fig.4: Prodhim kumulativ i naftes sipas vendburimeve.

Furnizimi me Gaz Natyror

Ne kuadrin e sektorit hidrokarbur, vend te rendesishem per plotesimin e nevojave te ekonomise me energji ze dhe gazi me nenproduktet e tij. Por ne situaten aktuale te vendit tone kontributi i tij vazhdon te jete teper i vogel pasi prodhimi vendas ka rene ne nivele teper te ulta dhe importimi i tij eshte i pamundur per shkak te moslidhjes me rrjetin nderkombetar te gazit.

Pavaresisht nga studimet e shumta vendi yne nuk eshte lidhur me rrjetin nderkombetar te gazit. Eshte per tu theksuar se Lidhja e Shqiperise me Rrjetin e Gazit do te kete nje ndikim ne permiresimin e situates energjetike ne vend duke ndikuar ne menyre te ndjeshme ne raportet e perdorimit te energjive ku deri me sot ngarkesa kryesore i takon energjise elektrike dhe produkteve te naftes.

Energjite e rinovueshme

Ne Shqiperi, perfitimi me i madh nga burimet e rinovueshme eshte nga hidroenergjia dhe me konkretisht nga hidrocentralet e medhenj. Vlen te permendim politikat mjaft efektive qe ndjek Qeveria Shqiptare ne nxitjen dhe zhvillimin e hidrocentraleve te vegjel, ku si pasoje e permiresimit te kuadrit ligjor dhe procedurave per investimet per keto vepra energjetike kane nje fluks gjithmonë e ne ritje. Ne vitin 1988, numeri i hidrocentraleve te vegjel ne Shqiperi ishte 83 me nje fuqi te instaluar prej 50 deri 1200 kW. Kapaciteti total i projektimit te tyre eshte 14 MW, por potenciali i tyre vleresohet ne 25 MW, kjo sepse per shumicen e tyre ekziston mundesia e rritjes se kapacitetit.

Interes ne vendin tone paraqet shfrytezimi i energjise diellore ku vlen te theksohet shfrytezimi i energjise diellore ne zonat e Fierit, Vlores, Durresit Sarandes etj, si rajone me rrezatimim vjetor te te larte.

Evidentimi i kushteve te favorshme per shfrytezimin e eres per qellime energjetike, lidhet me njohjen edhe te disa parametrave mjaft te rendesishem si: shpejtesia mesatare, sasia e oreve me ere ne vit mbi nje prag te dhene, probabiliteti i shfaqjes se ererave per pragje te ndryshme, shpejtesite maksimale te eres etj. Keto parametra do te sherbejne ne te ardhmen per nje studim me te thelluar ne kete fushe. Megjithate jane identifikuar disa zona atraktive si: Shkoder (Velipoje, Cas), Lezhe (Ishull Shengjin, Tale, Balldre), Durres (Ishem, P.Romano), Fier (Karavasta, Hoxhara 1, Hoxhara 2), Vlore (Akerni), Tepelene, Sarande.

Energjia gjeotermike nuk eshte marre ne konsiderate ne vendin tone, megjithese ka disa zona teper te pershtatshme per shfrytezimin e saj. Keshtu jane percaktuar tre hapsira gjeotermike: Hapesira gjeotermike e Ardenices qe eshte e perqendruar ne rajonin bregdetar, ku uji ka nje temperature 32-38°C, dhe me prurje 15-18 l/s. Hapesira gjeotermike e Krujes ku ndodhen burimet gjeotermike me te medha ne Shqiperi, me nje rezerve prej 5.9×10^8 - 5.1×10^9 GJ dhe hapesira gjeotermike e Peshkopise ne verilindje te Shqiperise, ku disa burime termike te lokalizuara afer njeri tjetrit kane nje temperature uji 43.5°C dhe prurje 14-17 l/s.

Biomasa eshte nje tjetër burim i rinovueshem energjie qe ka nje shtrirje pothuaj ne gjithe territorin e vendit tone. Pervec drureve te zjarrit qe vazhdojne te shfrytezohen ne menyre jo te qendrueshme nje interes te madh paraqesin edhe pasuria shume e madhe e shkurreve si dhe mbetjet e ngurta urbane. Persa i perket biomases nga bimet bujqesore, ajo s'mund te merret ne konsiderate pasi keto mbetje bujqesore perdoren per ushqim ose shtroje per kafshet gjate periudhes se dimrit. Ndersa biomasa e prodhuar nga blektoria s'mund te merret ne konsiderate per shkak te numrit jo te konsiderueshem te kafsheve shtepiake si dhe per faktin qe ato nuk jane te grupuara ne ferma blegtorale. Per kete arsye mbetjet jane te pakta dhe aktualisht ato perdoren si pleh organik.

1.3 Tarifat

Tarifat e energjise elektrike

Reforma tarifore ne sektorin e energjise elektrike ka perbere dhe perben per çdo vend qe kalon nga nje ekonomi e centralizuar ne nje ekonomi te mbeshetur ne tregun e lire nje nga çeshtjet me komplekse dhe me te ndjeshme, e cila shoqerohet me ndikime te konsiderueshme politike, ekonomike dhe sociale.

Reforma e tarifave te energjise elektrike ka filluar qe ne vitin 1994 me rritjen e konsiderueshme te tarifave te klienteve familjare, nivel i cili arriti ne vleren 4.5 leke/kwh ne vitin 2004. Ne vitet 2001-2006 ka patur keto zhvillime; konkretisht ne vitin 2003 arriti ne 4.1 leke/kwh per

konsumatorët nën konsumin 300 kWh dhe 8.8 leke/kWh (pa përfshirë TVSH) për bllokun e konsumatorëve familjare mbi nivelin e konsumit 300 kWh. Në vitin 2005 niveli i tarifës (pa TVSH) për konsumatorët familjare për bllokun deri 210 kWh ka qenë 4.5 leke/kWh dhe për të gjithë konsumatorët mbi nivelin e konsumit 210 kWh arriti nivelin e 9 leke/kWh. Në vitin 2006 u aplikua tarifa unioforme për të gjithë konsumatorët familjare në nivelin 7 leke/kWh i cili vazhdon edhe sot.

Rritje ndër vite e nivelit të tarifës mesatare ka sjellë impakt pozitiv në rezultatin financiar të KESH-it, por rezultatet do të ishin më shumë pozitive po të kemi parasysh që KESH-i duhet të vazhdojë të reduktojë nivelin e humbjeve teknike, jo-teknike dhe të mosarketimeve.

Çmimet e naftës dhe nënprodukteve të saj

Politika e çmimeve të lendeve djegëse ka qenë esenciale për investime sidomos në tregtimin e nënprodukteve të naftës dhe në lëndet e tjera energjetike. Çmimet e lendeve energjetike pas vitit 1991 dhe sidomos pas vitit 1992 filluan të ndryshojnë paralelisht me ecurinë e ekonomisë sone drejt ekonomisë së tregut. Gjate këtyre viteve ka pasur një levizje të madhe drejt liberalizimit të çmimeve të lendeve djegëse ku në një treg të lirë çdo furnizues është i lirë të bejë politiken e tij duke respektuar ndryshimet e çmimeve për konsumatorët.

Duke mbajtur në konsideratë këto situata një rendesi ka rregjimi fiskal për tregun hidrokarbur, gjate dhjetëvjeçarit të fundit janë bërë ndryshime thelbësore në përberësit e elementeve fiskale të nënprodukteve të naftës. Me miratimin e Ligjit nr. 9546, datë 29.05.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 9545, datë 29.05.2006 "Për një shtesë në ligjin nr.8981, datë 12.12.2002 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", të ndryshuar, që nga 01 Korrik 2006 elementet fiskale për nënproduktet e naftës do të pesojnë ndryshime esenciale, të cilat kanë të bëjnë me:

- Heqjen (berjen 0) të taksës doganore për të gjitha nënproduktet e importuara,
- Vendosjen e nivelit të akcizës të njëjtte si për gazoilin ashtu edhe për lëndet djegëse (solar, mazut, heating oil, vajguri për ngrohje),
- Përdorimin e akcizës së kombinuar me vlerë në % dhe me përcaktim të nivelit dysheme dhe tavan të kësaj vlerë.

1.4 Rezervat

Rezervat hidroenergjetike

Shqipëria renditet në Europë si një vend me pasuri ujore të konsiderueshme, me një shtrirje hidrografike të shpërndarë pothuaj në të gjithë territorin. Edhe pse rreth 98 % e energjisë elektrike prodhohet nga hidrocentralet vetëm 35% e potencialit hidroenergjetik është shfrytëzuar deri tani. Kapaciteti hidroenergjetik ekzistues i instaluar është rreth 1450 MW. Rezervat totale të hidroenergjisë vlerësohen rreth 4500 MW dhe potenciali vjetor shtesë i prodhimit mund të arrijë 16-18 TWh.

Ekzistojnë gjithashtu mundësi edhe për 41 HEC-e të vegjël që mund të ndërtohen në të ardhmen me kapacitet të mesëm dhe të vogël. Kapaciteti total i këtyre HEC-eve përllëgojë në 140 MW me një prodhim vjetor energjie prej rreth 680 GWh. Të gjithë HEC-et e vlerësuara janë të tipit me derivacion, pa diga dhe ujembledhësa.

Hidrokarburet

Potencialet nafte dhe gaz mbajtese te nentokes se vendit tone, te zhvilluara e prognozuara gjenden ne rezervuaret ranore e gelqerore, te cilet jane te dallueshem nga vete natyra e rezervuarit, karakteristikat kolektorale, veçorite e grumbullimit dhe ruajtjes se fluideve, energjine natyrale te prerjeve produktive si dhe te regjimit te perpunimit tyre.

Ne total sasia e naftes e grumbulluar fillimisht ne rezervuaret nentokesor te vendburimeve te njohura te vendit tone ka qene 437 Milion tone nafte. Ne varesi te natyres se rezervuarit natyror te vendburimeve te naftes rezulton se, ne vendburimet ranore kane qene depozituar 77,75 % te rezervave totale gjeologjike (pak me shume se 22 % te totalit). Deri tani jane nxjerre rreth 50.2 milion ton dhe ndodhen ende nentoke edhe rreth 386.4 milion ton nafte (rezerva gjeologjike).

Rezervat e gazit ne vendburimet e njohura te naftes e te gazit natyror te vendit tone me 01.01.2005 rezultuan se ndodhen si rezerva te nxjerreshme te gazit me se 3 miliarde e 630 milion m³N. Nga keto vetem afro 22 milion m³N gaz i perkasin vendburimeve te gazit natyror, ndersa 3 miliarde e 610 milion m³N gaz i perkasin vendburimeve te naftes e gazokondensatit ne trajten e gazit te tretur ne nafte apo te kondensuar dhe te gazit te lire ne kapelet gazore te disa vendburimeve.

Qymyri

Qymyri eshte nje nga burimet me te medha energjetike te Shqiperise dhe eshte i shperndare ne kater vendburime kryesore. Pellgjet tona qymyrgurore kane qymyre ne pergjithesi me fuqi te ulet kalorifike dhe me shtrese te vogel minerali, qe sjell kosto me te larte per njesi energjetike, ne krahasim me qymyret e importit.

Bashke me qymyri nje sasi e konsiderushme torfe eshte zbuluar ne zonen e Korçes (Maliq) rreth 156 milion m³ dhe Sarandes 1.3 milion m³. Torfa ndodhet ne fushen shume pjellore te Maliqit dhe te Sarandes me nje trashesi nga disa cm deri ne tre metra. Torfat jane te djegeshme me nxehtesi ne masen e punes 12180 [kJ/kg].

Energjite te tjera alternative

Shfrytezimi aktiv i energjise diellore realizohet ne sisteme qe absorbojne kete energji nepermjet kolektoreve te rrafshet. Uji i ngrohje mund te perdoret per ngrohjen e baneses, kur temperatura e tij eshte e larte. Megjithate perdorim me te gjere impiantet e energjise diellore kane gjetur per nevojat hidrosanitare. Deri tani kjo eshte teknologjia me premtuese dhe me me leverdi ekonomike per shfrytezimin e energjise diellore. Jane bere nje sere studimesh per instalimin e paneleve diellore ne sektorin e banesave dhe ne ate te sherbimeve. Nese Shqiperia do te zhvillonte sistemet e paneleve diellore, prodhimi (potenciali) i ujit te ngrohje do te jete ekuivalent me sasine e energjise prej 1000 GWh_{termik} (ose 125 MW_{termik} te fuqise se instaluar).

Energjia e eres ne vendin tone eshte nje mundesi potenciale per shfrytezimin e prodhimit te energjise elektrike. Vleresimet paraprake kane treguar se zonat me shpejtesi dhe kohezgjatje me te madhe ere jane ato te ultesires bregdetare, ne te cilen mund te ngrihen 20 EEC- e prane 20 hidrovoreve qe sherbejne per mbrojtjen e tokave nga permytjet. Ne se kjo behet realitet parashikohet qe deri ne vitin 2020 nga era te prodhohet rreth 400 GWh/vit.

Potenciali i mbetjeve te ngurta si lende djegese jepet nepermjet perberjes se tyre, fuqise kalorifike, permbajtjes se lageshtires dhe mases se padjegeshme. Rezervat energjetike te mbetjeve urbane per vitin 2005 jane 1.783 Mtoe dhe ne vitin 2020 parashikohen te jene 9.517

Mtoe. Mbetjet e ngurta mund te perdoren per perfitimin e energjise, por duhet theksuar se kosto e tyre eshte shume me e larte ne krahasim me lendet djegese tradicionale.

Burimet gjeotermike me te rendesishme ne vend jane: hapsira gjeotermike e Krujes me nje rezerve prej 5.9×10^8 - 5.1×10^9 GJ; hapesira gjeotermike e Ardenices dhe ajo e Peshkopise. Rezervat gjeotermike nuk mund te perdoren me leverdi ekonomike per qellime energjetike sepse potenciali i tyre termik eshte i ulet (temperatura maksimale 20-33°C).

Biomasa si burim energjie eshte ngushtesisht e lidhur me pyjet, bujqesine, mbetjet, industrine ushqimore dhe mbetjet urbane. Per kete, per te vleresuar potencialin e biomases ne Shqiperi, eshte e rendesishme te njihet zhvillimi i ketyre sektoreve dhe politika e ndjekur nga Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit. Rezultatet e disa vleresimeve paraprake (vleresime te publikuara nuk ka pasur ndonjehere ne Shqiperi) tregojne se mbetjet e prodhuara ne Shqiperi arrijne nje total prej rreth 0.4 Mtoe, nje shifer kjo ekuivalente me rreth 50% te prodhimit total primar te energjise ne 2005.

1.5 Organizimi i sektorit

Institucionet shteterore

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes (METE) perben autoritetin me te larte shteteror ne hartimin e politikave te pergjithshme ne sektorin e energjise. Misioni i METE-s ne sektorin e energjise eshte te stimuloje rritjen e qendrueshme ekonomike te vendit. Ajo percakton politikat ne nivel kombetar, politikat ne fushen e eficiences se energjise dhe masat e veprimit per zbatimin e ketyre politikave, duke mbajtur gjithmone ne konsiderate ceshtjet e mjedisit. METE ka autoritetin e mbikeqyrjes se aktivitetit te shoqerive shteterore KESH, Albpetrol dhe ARMO dhe ka te drejten e emerimit te te gjitha anetareve te Keshillave Mbikeqyrjes te ketyre shoqerive. METE ka ne varesi agjencite te meposhtme:

- Agjencia Kombetare e Energjise (AKE) u krijua me Vendim te Keshillit te Ministrave, ne Qershor 1998 si person juridik, publik, buxhetor, me seli ne Tirane dhe ne varesine direkte te Ministrit pergjegjes per ceshtjet e energjise. AKE-ja u krijua si bashkim i Komitetit Kombetar te Energjise dhe Agjencise Ekzekutive te Ngrohjes se Banesave, dy institucione qe ishin krijuar qe ne vitin 1993. Ajo keshillonte Ministrin pergjegjes per energjine, Qeverine dhe Ministrite e tjera mbi ceshtjet energjetike. Me VKM Nr.202 date 11.04.2007, AKE shkrihet si institucion dhe kalon ne varesi te AKBN-se.
- Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore (AKBN) eshte krijuar sipas VKM Nr. 547, date 09.08.2006 si rezultat i bashkimit te ish Agjencise Kombetare te Hidrokarbureve, Institutit te Nxjerrjes dhe Perpunimit te Mineraleve. AKBN-ja eshte institucion ne varesi te drejtperdrejte te Ministrit pergjegjes per energjine dhe zbaton politikat e Qeverise ne fushen e mineraleve, hidrokarbureve dhe hidroenergjetikes.
- Inspektoriati Qendror Teknik eshte krijuar me Ligjin Nr.9295, date 27.7.2006 si rrjedhoje e bashkimit te Inspektoriatit Shteteror te Kontrollit te Naftes dhe te Gazit, Inspektoriatit te Eneve nen Presion dhe Inspektoriatit te Paisjeve dhe Instalimeve Elektrike. Ky Inspektoriat ka per detyre te ushtroje kontroll tek te gjitha subjektet publike ose private lidhur me zbatimin e kerkesave, normave dhe standardeve te vendosura per instalimet elektrike, enet nen presion dhe nenproduktet e naftes.
- Enti Rregullator i Sektorit te Energjise Elektrike (ERE) u krijua zyrtarisht ne maj 1996 me emerimin e tre anetareve te Keshillit Drejtues te tij me VKM nr.263, date 22.04.1996 ne perputhje me ligjin "Per rregullimin e sektorit te energjise elektrike". Ai funksionon si nje institucion i pavarur dhe ka per detyre rregullimin e sektorit elektroenergjetik perfshire dhenien, ndryshimin dhe revokimin e licensave, percaktimin e tarifave, mbrojtjen e interesave te konsumatoreve te energjise elektrike.

- Qendra per Eficiencen e Energjise Shqiperi-BE (QEE) eshte krijuar me VKM ne qershor te vitit 1996, mbi bazen e nje marreveshje midis Qeverise shqiptare dhe BE. Roli i saj eshte nxitja e eficiences se energjise dhe perdorimi i burimeve te rinovueshme.

Organizimi i sektorit te energjise elektrike

KESH- i u krijua me VKM Nr. 340 date 12.08.1992 si nje ndermarrje shteterore ne te cilen u perfshine funksionet e gjenerimit, transmetimit dhe shperndarjes duke u shnderruar ne nje strukture vertikalisht e integruar.

Ne vitin 1995, ne perputhje me Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 “Per tranformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare” dhe Ligjin 7962, date 13.07.1995 “Per energjine elektrike” KESH-i kaloi ne nje shoqeri aksionere, aksionet e te ciles ishin 100% prone e shtetit, qe do te kuptonte se me tej KESH do te funksiononte si nje shoqeri tregtare ne perputhje me legjislacionin e shoqerive tregtare. Duke qene operatori i vetem ne sektorin e energjise elektrike, KESH-i siguronte vete aktivitetet e gjenerimit, transmetimit, shperndarjes, shitjes, eksportit dhe importit te energjise elektrike.

Sot KESH-i vazhdon te mbetet operatori kryesor, qe ka aktivitet ne sektorin e energjise elektrike, operon ne fushen e gjenerimit dhe te shperndarjes, me perjashtim te disa HEC-eve te vegjel te privatizuar ne vitet e fundit.

Ne Dhjetor 2003, Qeveria vendosi krijimin e nje shoqerie te re te quajtur Operatori i Sistemit te Transmetimit (OST), per menaxhimin dhe operimin e sistemit te transmetimit pershire edhe rolin e operatorit te tregut te energjise elektrike. Aktualisht jane percaktuar dhe ndare kapitalet e KESH-it dhe te OST-se dhe jane identifikuar kredite e marra nga kompania KESH.

OSSH (Operatori i Sistemit te Shperndarjes) eshte krijuar me VKM Nr.862, date 20.12.2006 “Per krijimin e shoqerise “Operatori i Sistemit te Shperndarjes” sh.a. Tirane”, ku jane percaktuar kriteret per krijimin e OSSH -se dhe eshte ne proces ndertimi i strukturave drejtuese. Ne te njejten kohe po punohet dhe per privatizimin e veprimtarise se sektorit te shperndarjes se energjise elektrike.

Per sektorin e Gjenerimit eshte hartuar projekt ligji per privatizimin e tij. Ne kete kuader kane filluar procedurat per miratimin e e ketij projekt ligji..

Te gjitha keto hapa te ndërmarra dhe nje pjese tyre te realizuara apo nen proces perbejne dhe angazhimin serioz te qeverise shqiptare perkundrejt obligimeve me direktivat e Bashkimit Europian, MSA-ne dhe Traktatin e Energjise.

Organizimi i sektorit te naftes dhe gazit

Organizimi i sektorit hidrokarbur realizohet ne linje horizontale, ku perfshihen disa Drejtori te Pergjithshme si Drejtoria e Pergjithshme e Politikave (DPP), Drejtoria e Pergjithshme Rregullatore, Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve Tregtare, te cilat sipas objektit te tyre, synojne te realizoje nje furnizimin te rregullt te konsumatoreve me burime energjetike hidrokarbure, duke qene nje mbeshtetje e sigurte per zhvillimin e qendrueshem ekonomik e social te vendit. Ne mbeshtetje dhe zbatim te legjislacionit ne fuqi, njesite administrative ne perberje te DPP-se, si strukture ne perberje te METE, eshte ngarkuar per te kryer formulimin dhe zbatimin e politikave te Qeverise per zhvillimin e industrise se naftes, kerkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, sigurimin e furnizimit te tregut me nafte, gaz dhe nenproduktet e tyre, percaktimin dhe formulimin e masave dhe rregullave per realizimin e rolit rregullator te shtetit ne tregun e naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre, si dhe vleresimin dhe sigurimin e rezerves se sigurise me keto produkte. Njesite qe mbulojne aktivitetin hidrokarbur ne perberje

te DPP organizojne dhe drejtojne planifikimin ne lidhje me studimin dhe kerkimin ne fushen e hidrokarbureve te lenget apo te gazte, si dhe per garantimin e furnizimit dhe diversifikimin e burimeve te furnizimit me nafte, gaz dhe neproduktet e tyre; marrin pjese ne formulimin e politikave dhe akteve juridike per ruajtjen dhe rehabilitimin e mjedisit ne zonat dhe instalimet ku shoqerite e sektorit hidrokarbur kryejne aktivitetin e tyre, ne mbeshtetje dhe zbatim te kuadrit ligjor ne fuqi dhe standarteve nderkombetare.

Megjithatë perfishirjen e operatoreve private ne te gjitha aktivitetet e sektorit te hidrokarbureve, qofshin ato ne kerkim, prodhim, transport apo tregtim, shoqerite publike vazhdojne te luajne nje rol te rendesishem sidomos ne prodhimin dhe rafinimin e naftes. Vitet e fundit per te gjitha keto shoqeri (me perjashtim te Albpetrol sh.a) eshte miratuar kuadri perkates ligjor per privatizimin e tyre. Liberalizimi i aktiviteteve ne sektorin e hidrokarbureve ka qene nje hap i rendesishem qe u shoqerua me nje perfishirje me te madhe te investitoreve private. Ne shoqerite te cilat funksionojne aktualisht ne vendit tone ne sektorin e hidrokarbureve, shteti vazhdon te luaje nje rol te rendesishem ne kete sektor, sidomos ne ate te prodhimit te naftes dhe gazit natyror dhe perpunimit e tregtimit te naftes te prodhuar ne vend. Aktualisht, ne sektorin publik te naftes dhe gazit operojne shoqeria Albpetrol sh.a pergjegjese per aktivitetin e kerkimit, prodhimit, sherbimeve ne shpim, sherbime gjeofizike te puseve, infrastrukture, etj. ARMO sh.a eshte pergjegjese per rafinerite (Ballsh, Fier) si edhe aktivitetet e shitjes me shumice dhe pakice te karburanteve (bazuar ne burimet e brendshme). Ne fushen e marketingut dhe tregtimit mbizoterojne shoqerite private te tregtimit, duke mbuluar rreth 60% te nevojave te tregut. Ne aktivitetin e kerkimeve mbizoterojne shoqerite e huaja te cilat operojne mbi bazen e marreveshjeve hidrokarbure te lidhura me shtetin shqiptar.

1.6 Situata e sektorit energjetik ne rajon

Vendet e Europes Jug-Lindore jane duke zhvilluar bashkepunim rajonal ne fushen e energjise. Traktati i Athines, i firmosur ne 25 tetor te vitit 2005 qe ka hyre ne fuqi ne korrik 2006, inkurajon krijimin dhe integrimin e tregjeve te energjise elektrike dhe te gazit ne rajon nen Tregun e Brendshem Energjetik te Komunitetit Europian. Vendet e rajonit gjenden ne shkalle te ndryshme te tranzicionit drejt tregjeve konkurruese. Per krijimin e ketij tregu ka disa ceshtje thelbeshore qe duhen analizuar dhe percaktuar ne te ardhmen me qellim qe vendet e rajonit ne tranzicion te bejne liberalizimin e tregut te brendshem ne vendet e tyre dhe njekohesisht te marrin pjese ne tregun rajonal, bazuar ne direktivat e BE-se, duke u kujdesur per zhvillimin ekonomik te tyre ne kushtet e nje ekonomie globale. Kjo perfishin: marredheniet midis rritjes ekonomike dhe kerkeses per energji, efektet e tarifave disproporcionale per sektore te ndryshem te ekonomise dhe shoqerise, vleresimin e potencialit per avantazhet e medha qe sjell nxitja e efencies se energjise dhe burimeve te rinovueshme te energjise, mundesine e nje roli shume me te madh te gazit natyral si dhe implikimet sociale qe do te vijne si pasoje e ristrukturimit te sistemit elektroenergjetik.

Aktualisht, sponsorizuar nga Banka Boterore, eshte azhurnuar Studimi i Investimeve te Gjenerimit (GIS), i cili adoptoi nje afrim rajonal per te arritur kerkesat per kapacitete gjeneruese te energjise elektrike per 15 vitet e ardhshme. Ky studim eshte fokusuar ne anen e furnizimit ne sektorin e energjise elektrike, qe lidh projektet per kerkesat e ardhshme per energji elektrike direkt me rritjen e ekonomise. Gjithashtu, Banka Boterore sapo ka komisionuar nje studim per te analizuar potencialin e rritjes se perdorimit te gazit natyror si pjese e Studimit per Gazifikimin e Rajonit (RGS). Bazuar ne GIS dhe RGS me asistencen e USAID-it, aktualisht po punohet per zgjerimin e analizes per planifikimin e hollesishem te sistemit energjetik per rajonin dhe Shqiperia, si nje nga vendet pjesemarrese shfrytezon keto projekte per njohjen e plote te sistemeve energjetike te vendeve te rajonit dhe shfrytezimin e mundesive maksimale per integrimin e sistemit energjetik shqiptar ne ate rajonal. Sipas studimit te USAID-it, ne rajon, te nente vendet nenshkruese te Traktatit te Komunitetit te Energjise do te kujdesen per modelimin e vleresimit te nevojave energjetike ne teresi, energjise elektrike dhe gazit natyror ne vecanti per te plotesuar GIS dhe RGS. Percaktimi i nevojave energjetike rajonale do te beje te mundur krijimin e nje kuadri i cili do te vleresoje alternativat qe mund te influencojne ne

perdorimin e energjise elektrike, si tarifat, perdorimi i burimeve te rinovueshme te energjise, menaxhimin e kerkeses dhe çeshtjet e zevendesimit te energjise elektrike me burime alternative dhe gaz natyror.

Furnizimi me energji primare ne Europen Jug-Lindore dominohet nga lendet djegese organike. Qymyri kontribuon ne bilancin total rajonal me 31% duke u ndjekur nga nenproduktet e naftes me 29% dhe gazi natyror me 22%. Pjesa qe ngelet mbulohet nga hidroenergjia, biomasa (qe mbulohet ne pjesen me te madhe nga drute e zjarrit ne masen 90%) dhe energji berthamore. Energjia diellore dhe ajo gjeotermike japin nje kontribut shume te vogel ne mbulimin e nevojave energjetike. Shqiperia, Mali i Zi, Bosnje Hercegovina mbeshteten ne prodhimin e energjise elektrike nga hidrocentralet. Qymyri eshte lenda djegese kryesore qe perdoret per prodhimin e energjise elektrike ne Kosove, Maqedoni, Serbi, Bullgari, dhe Rumani. Gjithashtu, duhet theksuar se Rumania, Bullgaria dhe Kroacia jane te vetmet vende ne rajon te cilat shfrytezojne edhe energjine berthamore per prodhimin e nje pjese te konsiderueshme te energjise elektrike. Vendet eksportuese neto jane Bullgaria, Rumania dhe Bosnia e Hercegovina. Ne vendet importuese perfshihen Shqiperia, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Kosova dhe Serbia. Siç shihet vendi kryesor eksportues eshte Bullgaria dhe me mbylljen e TEC-it Berthamor te Kozlloduit rajoni do te rrite varesine nga importi dhe do te kete me shume probleme persa i takon furnizimit me energji elektrike. Te ndodhur perballe kesaj situates pritet qe çmimi i energjise elektrike te importuar te rritet ne vlera shume te larta.

2. Vizioni, prioritetet dhe qëllimet strategjike

Vizioni

Vizioni i Strategjisë Kombëtare të Energjisë është përcaktimi i drejtimeve kryesore të zhvillimit të një sistemi të sigurtë energjetik, mbështetur në parimet e tregut, për plotësimin e kërkesave për energji për konsumatorët me kosto minimale, duke patur në konsideratë sigurinë e furnizimit, mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e mirëqenies së popullatës.

Prioritetet strategjike

Për realizimin e vizionit të mësipërm janë përcaktuar prioritetet e për rrjedhojë:

1. Ristrukturimi i sektorit energjetik shqiptar, bazuar në parimet e ekonomisë së tregut dhe në zhvillimin e një politike bashkëkohore energjetike për krijimin e një kuadri efektiv institucional, ligjor dhe rregullator të shoqërive publike energjetike me synim privatizimin e shpejta të tyre.
2. Nxitja e përdorimit eficient të energjisë, ekonomik dhe me ndikim minimal në mjedis, në mënyrë të tillë që sektori energjetik të jetë një sektor mbështetës për një zhvillim të qendrueshëm të të gjithë sektoreve të tjera ekonomik dhe shoqëror.
3. Optimizimi i sistemit të furnizimit me burime energjetike, duke u mbështetur në konceptin e planifikimit me kosto më të ulët dhe ndikim minimal në mjedis.
4. Rritja e sigurisë së furnizimit me burime energjetike nëpërmjet diversifikimit të sistemit energjetik dhe ndërtimit të veprave të reja gjeneruese dhe linjave të interkonjeksionit.
5. Nxitja e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë (diellore, HEC-et e vegjël, erë dhe biomasa), për të bërë të mundur shfrytëzimin në maksimum të burimeve lokale.
6. Hapja e tregut të brendshëm të energjisë elektrike dhe pjesëmarrje aktive në tregun rajonal të saj, në kuadrin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë të Vendeve të Europës Juglindore, i cili bazohet në kërkesat e Bashkimit Europian për reformimin e sektorit elektroenergjetik (Direktiva 54/2003 e BE-së).

3. Politikat

Ne strategji eshte bere nje analize krahasuese e dy skenareve kryesore, qellimi i te ciles eshte te ilustruhet se cfare mund te ndodhe ne se nuk ndermerren iniciativa pervec atyre pak iniciativave te koordinuara keq qe jane ndermarre deri tani. Kjo eshte krahasuar me impaktet e nje politike te koordinuar me kujdes drejt arritjes se nje kursimi energjie ne shkalle te gjere dhe permiresimeve te efences ne konsumin e energjise kombinuar me nje perdorim optimal te burimeve te brendshme energjitike, sidomos hidroenergji.

Hartimi i skenareve ne perditimin e Strategjise Kombetare te Energjise jane bere sipas softit te titulluar "Planifikimi Afatgjate me Skenare i Energjise" (LEAP-Long Energy Alternative Planning) i cili siguron analizat e nevojshme dhe jep rekomandime sa me afer realitetit mbi nje strategji energjie, pershtatur per kushtet e Shqiperise. Softi eshte zhvilluar per ilustrimin e skenareve te ndryshem deri ne vitin 2020, per te analizuar pasojat e politikave energjitike dhe efekteve te jashtme te lidhura me keto politika energjitike. Hartimi i Strategjise ka perdorur dhe programin MARKAL, ne arritjen e objektivave per nje sistem energjetik eficient dhe ne harmoni me politikat dhe objektivat e Bashkimit Europian per sa lidhet me sigurine e furnizimit, krijimin e tregjeve konkurruese te energjise, nxitjen dhe perdorimin e burimeve te rinovueshme, diversifikimin e burimeve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Skenaret nuk pretendohet te jene parashikime te sakta, por ato pershkruajne dy limite brenda te cileve sistemi shqiptar i energjise ka shume te ngjare qe te zhvillohet. Skenaret pershkruajne mundesite afat mesme te zhvillimit te sektorit energjetik shqiptar duke u bazuar edhe ne parashikimin e ardhshem teknologjik dhe ekonomik te vendeve te saj fqinje me te aferta si nga ana e zhvillimit ekonomik ashtu edhe nga kushtet klimaterike, gje qe eshte shoqeruar me pranimin e disa tendencave te zhvillimit te ardhshem te vendit.

Zhvillimi i sistemit energjetik sipas skenarit pasiv

Skenari pasiv supozon ruajtjen dhe zhvillimin e formes aktuale si ne anen e furnizimit ashtu edhe ne ate te kerkeses per energji per te gjitha sektoret ekonomike te vendit. Ai ruan vazhdimesine e konsumit energjise elektrike si burimi dominues per ngrohje dhe uje te ngrohje ne sektoret e banesave dhe ate te sherbimeve. Ky skenar merr parasysh masat qe ka vendosur te ndermarra nga Qeveria, per nje periudhe afat-shkurter duke mos zbatuar me rigorozitet zbatimin e planit te veprimeve. Skenari tregon se moszbatimi i ketyre masave e con ne veshtiresi te medha sektorin energjetik ne teresi dhe ate elektrik ne vecanti. Disa nga konkluzionet me te rendesishme te zhvillimit te sistemit energjetik sipas skenarit pasiv jane:

- Tipari kryesor i situates energjitike eshte fakti qe vete-plotesimi i nevojave te Shqiperise me burime primare energjitike ka tendence renie sepse kerkesa e larte per burime energjitike eshte e pa mjaftueshme te perballohet dhe me rritje te lehta te burimeve primare. Gjithashtu sistemi elektrik per te mbuluar nevojat eshte kthyer ne nje importues neto. Keto faktore do te kene ndikim edhe me te madh mbi bilancin tregtar te energjise dhe si rrjedhim ne bilancin e pergjithshem tregtar te vendit ne se sektori vazhdon te zhvillohet sipas skenarit pasiv, ku nevojat per te importuar gjithnje e me shume lende djegese do te rrisin deficitin tregtar pertej niveleve qe mund te perballohen nga ekonomia shqiptare.
- Zhvillimi i sektorit energjetik do te coje ne rritjen e konsumit te energjise per banore, por ne te njeten kohe do te rrise ndjeshem edhe intensitetin energjetik. Kjo do ta beje ekonomine shqiptare akoma me pak konkurrencte, gje qe do te thote humbje e tregjeve te tanishem dhe per pasojte deficiti tregtar do te rritet akoma edhe me shume.
- Sic u tregua edhe ne analizen e detajuar te bere me siper zhvillimi i sistemit energjetik sipas skenarit pasiv eshte me pasoja te medha ekonomike, rritje te deficitit tregtar energjetik per vendin si dhe rritje te tejskashme te emetimeve te ndotesave ne atmosfere. Prandaj duhet

te merren te gjitha masat per te bere te mundur zhvillimin e sistemit energjistik shqiptar sipas skenarit aktiv, i cili do te pershkruahet ne detaje ne kapitullin ne vijim.

- Duke vleresuar ne menyre sasiore nevojat energjitike dhe koston e plotesimit te ketyre nevojave, skenari tregon qe eshte e domosdoshme, qe te zbatohet me rigorozitet Plani i Veprimeve te Sektorit te Elektroenergjiise, sepse ne rast te kundert sistemi energjistik do te vazhdoje te ricikloje kriza si ajo e dimrit te kaluar. Si konkluzion, ky skenar vlereson ne menyre sasiore se sa problematik eshte zhvillimi i sektorit energjistik sipas skenarit pasiv duke cuar ne marrjen e vendimeve te gabuara ne instalimin e kapaciteteve te reja gjeneruese te panevojshme ne sektorin e energjiise elektrike. Skenari supozon se nje pjese e madhe e kerkeses se ardhshme per energji elektrike do te mbulohet nga zgjerimi i kapaciteteve gjeneruese termike (bazuar tek dizeli i marines, solari, mazuti ose gazi natyror i importuar) dhe hidroenergjitika.

Zhvillimi i sistemit energjistik sipas skenarit aktiv

Ndertimi i skenarit aktiv ka mbajtur ne konsiderate te njejtat parametra udhezues si ne skenarin pasiv. Treguesit kryesore makroekonomik jane mbajtur te pa ndryshueshem brenda te njejtës dege ekonomie, por ndryshojne brenda per brenda te se njejtës nendege. Situata energjitike sipas skenarit aktiv tregon reduktimin te konsumit energjetik sipas sektoreve ekonomike dhe ne total kap vleren prej 1106 ktoe me pak krahasuar me skenarin pasiv per vitin 2020, tregon reduktim te varesise nga importi. Disa nga konkluzionet me te rendesishme te zhvillimit te sistemit energjistik sipas skenarit aktiv jane:

- Situata energjitike sipas skenarit Aktiv tregon reduktimin te konsumit energjetik sipas sektoreve ekonomike dhe ne total kursimi arrin vleren prej 1106 ktoe krahasuar me skenarin Pasiv per vitin 2020, duke sjelle avantazhe per rritjen e nivelit te plotesimit te nevojave per energji, reduktim te sasise se energjiise elektrike nga importi e shoqeruar me kursimin e vlerave monetare.
- Ne vecanti sistemi elektrik perballat akoma me veshteresi per te permbushur kerkesen per energji elektrike dhe vendi eshte kthyer ne importues te konsiderueshem, por me zhvillimin e skenarit Aktiv keto vlere paraqiten me te ulta krahasuar me skenarin Pasiv, kursim qe arrin ne vleren prej 3537 GWh ne vitin 2020.
- Treguesi i veteplojesimit se furnizimit me nafte ne skenarin aktiv eshte 19% dhe ne skenarin Pasiv do te jete 14 %.
- Analiza tregon qe nevojat energjitike per secilin sektor ne skenarin Aktiv rriten perkatesisht: per sektorin e banesave kursimi rritet ne vitin 2020 nga 245 ktoe ne vitin 2008, sektori i sherbimeve respektivisht per vitet 2008-2020 (kur fillojne masat e eficiencies) arrin vlerat nga 9 ktoe ne 195 ktoe, sektori i industrise respektivisht 2008-2020 nga 12 ktoe ne 249 ktoe, industria 2008-2020, shkon ne vlerat 20 ktoe ne 290 ktoe, bujqesia viete 2008-2020 shkon ne vlerat nga 9 ktoe deri ne 127 ktoe.
- Kontributi me i madh ne kete kursim parashikohet te vije nga nga sektori i transportit me 26.2%, sektori i industrise me 22.54%, sektori i banesave 22.15%, sektori i sherbimeve me 17.6% dhe sektori i bujqesise me 11.4% perkundrejt totalit te burimeve energjetike per vitin 2020.
- Parashikimi i reduktimit te nivelit te humbjeve ne sistemin elektroenergjetik, si rezultat i investimeve te parashikuara per tu realizuar, duhet te coje ne nje nivel te tyre ne 10 % ne vitin 2020.

- Kontributin kryesor ne bilancin energjetik e japin nafta, hidroenergjia (perfshire importin e energjise elektrike) si dhe drute e zjarrit. Kontributi i naftes, hidroenergjise drute te zjarrit si dhe energjise diellore ne vitin 2020 do te jene respektivisht, nafta me nen produktet e saj 63 %, energjia elektrike 30 % dhe drute e zjarrit 7 % te totalit te burimeve te energjise .
- Investimet totale te kerkuara per te mbuluar vetem nevojat per gjenerimin e energjise elektrike kapin vleren 1015 Milion Euro. Per kete kerkohet patjeter percaktimi i sigurimit te burimeve te financimit per kete arsye eshte e domosdoshme te hartohen politika te zbatueshme per terheqjen e investitoreve private dhe te financimeve nga vete qeveria shqiptare per implementimin e investimeve te nevojshme ne sistemin elektroenergjetik.
- Nevojat per investime ne sisteminne transmetimit dhe te shperndarjes kapin vlereat (2020) ne 671.55 Milion Euro.
- Lidhur me ecurine e prodhimit te naftes Varianti 1 i paraqitur dhe i rekomanduar nga strategjia (me ecuri normale), parashikon nje ecuri te prodhimit te naftes deri ne vitin 2006, me pas rritja e prodhimit nuk do te jete me shume se 600 Ktoe ne vit deri ne vitin 2010 per te arritur ne 344 Ktoe ne vitin 2020. Ne anlizen e skenarit aktiv, kjo alternative do te merret ne konsiderate, pasi ruan nje ecuri normale te shfrytezimit te vendburimit. Prodhimi i Albpetrolit eshte marre i njejte ne te dy skenaret.
- Kosto totale njesi e prodhimit te rafinerive sipas skenarit aktiv varion nga 140-147\$/ton, e cila konsiderohet shume e larte. Per kete arsye kerkohet rehabilitimi i rafinerive tona per te qene konkurruese perkundrejt nenprodukteve te importit.
- Ne skenarin Aktiv sikurse dhe ne Pasivin, penetrimi i gazit natyror ne energjitiken shqiptare ka pak te ngjare te realizohet para vitit 2010. Por, ne se gazi natyror penetron ne energjitiken shqiptare, ai paraqet me shume leverdi te perdoret per prodhimin e energjise elektrike se sa TEC-et me diesel marine. Sidoqofte, TEC-et e rinj do te ndertohen jane marre parasysh qe te punojne si me diezel marine ashtu edhe me gaz natyror. Analiza tregon se emetimet e CO₂ per banore sipas skenarit aktiv ashtu edhe emetimet e CO₂ per GDP zvogelohen ne krahasim me skenarin pasiv, si rezultat e masave dhe normave mjedisore te marra parasysh ne skenarin aktiv.
- Skenari aktiv simulon nje zhvillim intesiv te terminaleve te produkteve te naftes ne funksion te kekesave te tregut dhe ne plotesimin e normave Europiane te sigurise se furnizimit.
- Parashikimi me i ulet i kerkeses per energji ne skenarin aktiv, diversifikimi i burimeve energjetike, rritja e sigurise se furnizimit dhe reduktimi i varesise nga importi kerkon te merren te gjitha masat dhe te realizohen te gjitha investimet e parashikuara per tu implementuar qe sistemi energjetik shqiptar te zhvillohet sipas skenarit Aktiv, duke bere te mundur garantimin e rritjes se konsumit te energjise per banore dhe njekohesisht zvoglimin e intensitetit energjetik. Kjo do te thote se ekonomia shqiptare do te konsumoje akoma me pak energji per te prodhuar te njejten njesi prodhimi. Kjo do ta beje ekonomine shqiptare me konkurrenente, gje qe do te thote integrimin e Shqiperise ne sistemin europian (te energjise elektrike) ne tregun rajonal, me shume punesim, mireqenie me te larte dhe per pasoje nje deficit tregetar qe zvogelohet vit pas viti duke krijuar mundesi qe burimet financiare te perdoren per investime te ndryshme ne ekonomine shqiptare.

Konkluzioni perfundimtar qe rezulton nga krahasimi i te dy skenareve bazuar ne investimet totale, per te gjitha periudhen 2003-2020, tregon se vlera kumulative e saj eshte 11.84 Miliard Euro per skenarin Pasiv dhe per skenarin Aktiv eshte 11.094 Miliard Euro. Pra si rezultat kemi nje kursim monetar prej 720 Milion Euro ne skenarin Aktiv, duke garantuar nje zhvillim ekonomik te njejte, mireqenie te njejte si dhe duke hedhur 20-25% me pak ndotesa ne

atmosfera.

Në këtë kapitull bëhet një renditje e politikave të strategjisë sipas prioritetit strategjik.

3.1 Ristrukturimi i Sektorit Energjetik Shqiptar dhe Krijimi i Nje Kuadri Efektiv Institucional dhe Rregullator

Implementimi i kesaj strategjie, do te kerkoje institucione te qendrueshme dhe me kapacitetet e nevojshme profesionale, si dhe nje kauder ligjor qe do te mundesoje perfshirjen e shpejte te sektorit privat, qofte ai vendas apo i huaj, duke sjelle ne kete sektor jo vetem burime te reja investuese, por edhe nje teknologji edhe me moderne dhe te perparuar.

Organizimi i institucionet shteterore

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes do te vazhdoje te luaje rolin kryesor ne hartimin e politikave te zhvillimit te sektorit te energjise, por ne te njejten kohe duke qene perfaqesuese e te drejtes se pronesise se shtetit mbi shoqerite publike te sektorit te energjise ajo do te vazhdoje te jete pergjegjese me miremenaxhimin e ketyre shoqerive deri ne privatizimin e mundshem te tyre.

Duke patur parasysh objektivin afatgjate te Shqiperise per integrimin ne familjen e vendeve te BE-se, harmonizimi i politikave te zhvillimit te sektorit energjetik, dhe jo vetem atyre, me ato te BE-se do te perbeje nje nga prioritet e Qeverise Shqiptare ne pergjithesi dhe te METE ne vecanti. Neshkrimi dhe ratifikimi i Marreveshjes se Asocim-Stabilizimit te Shqiperise me BE-ne nga Kuvendi i Shqiperise me ligjin nr.9590, date 27.07.2006, ka vendosur per Qeverine dhe institucionet e administrates se saj nje sere detyrash dhe objektivash qe do te kerkojne nje angazhim te plote te te gjitha strukturave dhe nje rritje te kapaciteteve profesionale dhe intelektuale te specialisteve shqiptare. Mbeshtetur ne kete ligj Keshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 463, date 5.07.2006 Planin Kombetar te Zbatimit te Marreveshjes se Asocim-stabilizim. Perafrimi i legjislacionit shqiptar me Acquis Communautaire te BE-se, i cili mund te thuhet se tashme ka filluar, do te jete nje proces sa i veshtire aq edhe delikat. Per kete qellim, METE do te punoje per nje zgjerim dhe forcim te sektorit te perafimit te legjislacionit me ate te BE-se, i cili duhet te koordinoje me te gjitha institucionet ne varesi te METE te gjithë procesin e perfarimit te legjislacionit ne sektorin e energjise.

Persa i perket menaxhimit te asetëve te shoqerive publike, METE duhet te rrise dhe te forcoje rolin e Drejtorise se Menaxhimit te Shoqerive Publike, e cila duhet te pergatise nje sistem raportimi dhe vleresimi te ketyre shoqerive. Ne te njejten kohe, kjo drejtori duhet te rrise rolin e saj ne pergatitjen e shoqerive publike per nje privatizim te mundshem te tyre.

Miratimi i ligjit te ri te koncesioneve Nr.9663, date 18.12.2006, kerkon nje rritje te rolit te METE-s si nje institucion kyc ne te gjitha koncesionet ne pergjithesi dhe ne ato te sektorit te energjise ne vecanti. Kjo Ministri do te punoje ne identifikimin dhe lancimin e koncesioneve te mundshme ne sektorin e energjise. Nje rendesi te madhe, persa i perket promovimit te koncesioneve, marrin propozimet e kerkuara te cilat kerkojne dhe studime te detajuara te atyre objekteve qe planifikohen te jepen me koncesion.

Nje fushe e rendesishme e veprimtarise se METE-s ne te ardhmen eshte ajo e pergatitjes se normave dhe standarteve te projektimit, instalimit dhe operimit te pajisjeve dhe instalimeve elektrike, standarteve te cilesise dhe sigurise se burimeve energjetike, paisjeve qe perdoren ne tregtimin e nen-produkteve te naftes duke rritur sigurine e konsumatoreve dhe subjekteve te perfshira ne keto veprimtari . Ne vendosjen ketyre normave dhe standarteve, duhen mbajtur parasysh ato te BE-se, duke plotesuar dhe nje nga kerkesat dhe detyrimet qe dalin nga marreveshja e stabilizim-asocimit me BE-ne.

Organizimi i sektorit te energjise elektrike

Edhe pse vitet e fundit sektori i energjise elektrike i eshte nenshtruar procesit te reformimit, ne kuadrin e zhvillimeve te reja ne vend dhe ne rajon ky sektor do te vazhdoje te jete objekt i reformimit te metejshe. Futja e investimeve private, sidomos ne gjenerimin e energjise elektrike, hapja dhe konsolidimi i nje tregu kompetitiv si dhe synimet dhe objektivat e qeverise per privatizimin e sektorit te shperndarjes, e bejne te domosdoshme reformimin e ketij sektori.

Ndarja e KESH-it dhe krijimi i KESH “holding”-ut. Nderkohe qe ligji per sektorin e energjise elektrike kerkon qe nje shoqeri qe kryen dy ose me shume aktivite ne sektorin e energjise elektrike, duhej t'i mbaje llogarite financiare te ndara per secilin aktivitet, Modeli Tranzitor i Tregut i miratuar nga Qeveria ne Gusht 2004 kerkon qe aktivitetet e transmetimit dhe shperndarjes, qe perbejne aktivite monopol, te jene te ndara nga aktivitetet e tjera ne kete sektor si ai i gjenerimit dhe furnizimit, per te mundesuar nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe pjesmarresit ne sektor.

Ndarja dhe konsolidimi i Operatorit te Sistemit te Transmetimit (OST). Mbeshtetur ne vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 797, date 4.12.2003 “Per krijimin e shoqerise “Operatori i Sistemit te Transmetimit” sh.a., Tirane” ndarja e OST-se ishte hapi i pare drejt ndarjes se KESH-it. Shoqeria OST-se eshte rregjistruar si person juridik ne korrik 2004 si nje filial i KESH sh.a.-se, nderkohe qe gjate kesaj kohe eshte punuar per konsolidimin e saj. Mbeshtetur dhe ne asistencen teknike te konsulenteve te Bankes Boterore, OST ka ndermarre nje sere veprimesh dhe masash per kete konsolidim. Miratimi i nje strukture te re organizative, e shoqeruar me percaktimin e funksioneve dhe pergjegjesive te cdo departamenti, sektori ose zyre, si dhe te pershkrimtit te detyrave per cdo pozicion brenda shoqerise perben nje zhvillim te rendesishem per OST-ne.

Miratimi nga ana e ERE-s e tarifes se transmetimit e cila eshte bere efektive qe nga 1 korriku 2006, sigurisht qe ka shenuar nje hap te rendesishem ne ndarjen e metejshe financiare te OST-se, por nga ana tjetere kjo tarife eshte nje tarife e perkohshme pasi ajo eshte mbeshtetur vetem ne kostot operative te shoqerise. Ne kete kuader KESH sh.a. dhe OST sh.a kane miratuar raportin e ekspertit kontabël mbi ndarjen e llogarive financiare ne OST sh.a dhe ndryshimet ne kapitalin e KESH -it sh.a, gjithashtu ky raport eshte miratuar dhe nga keshilli mbikqyres KESH sh.a dhe OST sh.a. Ky transferim eshte i rendesishem jo vetem per pergatitjen e pasqyrave te reja financiare te OST-se, por ne te njejten kohe do te ndikoje ne llogaritjen dhe propozimin e nje tarife sa me reale te transmetimit.

Mbeshtetur ne amendamentin e ligjit per sektorin e energjise elektrike te majit 2006 dhe ne Modelin Tranzitor te Tregut, OST-ja, pervec funksioneve te menaxhimit te rrjetit te transmetimit dhe te operatorit te sistemit te transmetimit, eshte ngarkuar edhe me pergjegjesine e operatorit te tregut. Duke qene nje funksion rekativisht i ri per nje shoqeri si OST-ja, kerkohet qe Operatori i Tregut te jete nje nga perpaesite e kesaj shoqerie. Kompletimi i zyles se Operatorit te Tregut si me stafin e nevojshem profesional ashtu dhe me infrastrukturen e nevojshme te IT-se dhe programeve kompjuterike do te jete shume e rendesishme per implementimin e suksesshem te modelit te tregut.

Ndarja e Operatorit te Sistemit te Shperndarjes (OSSH). Ne kuadrin e procesit te privatizimit te aktivitetit te shperndarjes Keshilli i Ministrave miratoi vendimin Nr.862, date 20.12.2006 “Per krijimin e shoqerise “Operatori i Sistemit te Shperndarjes” sh.a. Tirane”, e cila do te jete pergjegjese per menaxhimin dhe operimin e sistemit te shperndarjes dhe ne te njejten kohe do te luaje edhe rolin e furnizuesit publik per klientet tarifore. Megjithate, deri ne privatizimin perfundimtar te saj, aksionet e kesaj shoqerie do te vazhdojne te jene prone e KESH sh.a-se. Duke qene se procesi i ndarjes dhe konsolidimit te OSSH-se do te kaloje neper te njejtin proces si ai i OST-se, pritet qe ndarja e shperndarjes te kryhet brenda nje kohe me te shkurter.

Ne te njejten kohe qe shoqeria e shperndarjes ndahet, do te punohet edhe ne ndarjen e llogarive financiare midis veprimtarise se shperndarjes dhe asaj te furnizimit. Kjo do te

mundesoje shmangjen e devijimit te kostove te furnizimit ne koston e shperndarjes dhe per pasoje ne rritjen e padrejte te tarifes se shperndarjes.

Ndarja e shperndarjes do te shoqerohet edhe me pergatitjen e saj per nje privatizim sa me te shpejte, gje qe mund te kerkoje edhe nje reduktim te numrit te punonjesve ne shperndarje.

Krijimi i shoqerise se TEC-it te Vlores. Ndertimi i TEC-it te Vlores do te paraprihet nga krijimi i nje shoqerie filial i KESH sh.a-se. Shoqeria e re do te ndertoje, menaxhoje dhe operoje TEC-in e ri te Vlores, i cili pritet te filloje se shpejti me fondet e financuara nga BB, BERZH dhe BEL. KESH-i do te nenshkruaje nje PPA me kete ndermarrje per blerjen e energjise elektrike te prodhuar nga kjo e fundit.

Organizimi i sektorit te gjenerimit publik. Divizioni i gjenerimit aktualisht eshte i organizuar sipas kaskadave ne te cilat jane ndertuar HEC-et ekzistuese dhe termocentralit te Fierit dhe operon brenda shoqerise KESH sh.a. Ndarja e OST-se dhe OSSH-se dhe krijimi i nje shoqerie te re per TEC-in e ri te Vlores kerkon edhe rishikimin e struktures aktuale te gjenerimit publik. Studimet e bera nga konsulente te ndryshem nderkombetare kane treguar se organizimi mbi baza kaskade mbetet si organizimi optimal, po te mbahet parasysh qe operimi i centraleve te nje kaskade eshte i ndervarur. Per kete arsye gjenerimi publik do te organizohet ne tre shoqeri te reja gjenerimi filiale te KESH sh.a-se si me poshte:

1. Tre HEC-et ne kaskaden e Drinit,
2. Dy centralet ne kaskaden e Matit,
3. Hidrocentralet e tjere.

Me krijimin e ketyre shoqerive, shoqeria KESH sh.a do te shnderrohet ne nje shoqeri "holding" e cila do te jete pronare e aksioneve te te gjitha shoqerive te reja te krijuara dhe do te mbikqyre aktivitetin e tyre.

Per sa me siper per sektorin e Gjenerimit eshte hartuar projekt ligji per privatizimin e tij. Ne kuader te privatizimit te divizionit te gjenerimit kane filluar procedurat per nisjen e privatizimit bazuar ne projekt ligj ne te cilin do te percaktohen te gjitha hapat, kriteret perkatese.

Organizimi i shoqerive publike ne sektorin e hidrokarbureve

Aktualisht ne sektorin publik te naftes dhe gazit operojne 4 shoqeri publike: Albpetrol sh.a, ARMO sh.a, Uzina Mekanike e Naftes (UMN) shpk. Kuçovë dhe Uzina Mekanike (UM) shpk Patos. Megjithese te gjitha keto shoqeri jane planifikuar qe te privatizohen ne funksion te kesaj detyre eshte pergatitur dhe kuadri i nevojshem ligjor, deri tani ky proces nuk ka qene i suksesshem. Menaxhimi i kujdesshem dhe ri-pergatitja e ketyre shoqerive per privatizim do te mbeten objektivat kryesore lidhur me keto shoqeri.

Permiresimi i kuadrit ligjor

Reforma e nisur lidhur me kuadrin institucional dhe legjisacionin e sektorit energjetik do te vazhdoje te mbetet nje nga ceshtjet me te rendesishme te te gjitha strategjise se zhvillimit te ketij sektori te rendesishem dhe jetik. Implementimi i kesaj strategjie, do te kerkoje institucione te qendrueshme dhe me kapacitetet e nevojshme profesionale, si dhe nje kauder ligjor qe do te mundesoje perfshirjen e shpejte te sektorit privat, qofte ai vendas apo i huaj, duke sjelle ne kete sektor jo vetem burime te reja investuese, por edhe nje teknologji edhe me moderne dhe te perparuar.

Ligji per sektorin e energjise elektrike

Zhvillimi dhe rregullimi i sektorit te energjise elektrike mbeshetet ne ligjin nr.9072, date 22.05.2003, qe eshte dhe ligji baze i ketij sektori.

Ligji eshte mbeshetur ne eksperiencen e vendeve me te zhvilluara dhe ka marre parasysh shume prej dispozitave te Direktivave te BE per tregun e brendshem te energjise elektrike. Ligji perben nje hap te rendesishem drejt ristrukturimit te ketij sektori jetik per zhvillimin e gjithe ekonomise se vendit.

Ligji permban edhe nje numer dispozitash lidhur me krijimin dhe zhvillimin e nje tregu kompetitiv ne sektorin e energjise elektrike ne perputhje me Direktivat e BE-se. Ligji ngarkon ERE-ne, qe ne bashkepunim me pjesmarresit e tjere te sektorit te energjise elektrike, t'i propozojte Keshillit te Ministrave modelin e tregut dhe pas miratimit te modelit te filloje pergatitjen dhe miratimin e rregullave te tregut.

Zhvillimet e vrullshme ne kete sektor si pasoje e krijimit te nje tregu kompetitive ne kete sektor nepermjet miratimit te nje modeli tregu, i cili po rishikohet, perfshirjes se investitoreve private si dhe Direktiva e re e BE-se 2003/54/EC e tregut te energjise elektrike dhe hyrja ne fuqi e Traktatit te Komunitetit te Energjise ne vendet e Europes Juglindore, kane bere te nevojshme rishikimin e dispozitave te ketij ligji ne menyre qe te reflektoje te gjitha keto ndryshime. Rishikimi i ketij ligji do te shoqerohet edhe me rishikimin e shume prej akteve nenligjore te miratuara nga ERE ne zbatim te ketij ligji, si Rregullat e Tregut, Kodet e Transmetimit, Shperndarjes dhe Matjes, procedurat e licensimit etj per te mundesuar harmonizimin e plote te tyre.

Nje ligj te ri per energjite e rinovueshme.

Nxitja e ketyre burimeve eshte kthyer nje nga shtyllat e zhvillimit te sektorit te energjise te BE-se e materializuar me Direktiven 2001/77/EC per promovimin e prodhimit te energjise elektrike nga burimet e rinovueshme, dhe e shume prej vendeve me te zhvilluara perfshire Gjermanine, Austrine, Danimarken, Hollanden, Spanjen, Portugaline, Greqine etj te cilat kane adoptuar nje legjislacion qe garanton dhe nxit investimet ne keto burime. Edhe pse rritja e prodhimit te energjise elektrike nga burimet e rinovueshme ne vendet e BE-se eshte e kushtezuar edhe nga detyrimet qe ato kane ne kuadrin e Protokollit te Kyotos per reduktimin e emetimeve te gazeve te efektit sere, perseri ato kane nje rendesi te madhe edhe persa i perket rritjes se sigurise se furnizimit me energji elektrike, ne uljen e varesise se plotesimit te nevojave me energji nga importi dhe ne zhvillimin e zonave relativisht larg qendrave te zhvilluara. Nga ana tjeter nxitja e burimeve te rinovueshme te energjise dhe krijimi i ligjit per energjite e rinovueshme perben dhe nje nga kerkesat e Traktatit te Energjise, pale e te cilit eshte edhe vendi yne.

Kohet e fundit eshte vene re nje interes nga ana e investitoreve te ndryshem private per te investuar ne ndertimin e centraleve me ere. Marreveshja ndermjet Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes dhe Ministrise se Mjedisit te Italise per njohjen reciproke te certifikatave te origjines dhe te certifikatave jeshile perben nje hap te rendesishem ne drejtim te rritjes se interesit te investitoreve te vendeve qe kane detyrime per reduktimin e gazrave te efektit sere. Ligji do te inkurajoje Qeverine Shqiptare qe te lidhe edhe marreveshje te tjera me vendet qe kane interes te investojne ne shfrytezimin e burimeve te energjive te rinovueshme ne vendin tone.

Ligji per eficensen e energjise. Qellimi i ketij ligji eshte krijimi i kuadrit ligjor te nevojshem per hartimin dhe zbatimin e politikës kombetare per perdorimin efiçent te energjise dhe per reduktimin e humbjeve te energjise ne te gjithe ciklin e saj. Ky ligj do te kontribuojte per perdorimin ekonomik te burimeve te energjise, per krijimin e furnizimeve me te qendrueshme me energji, per minimizimin e ndikimit te demshem mbi mjedisin dhe si mbeshetje per

zhvillimin e qendrushem te shoqerise. Mbeshtetur ne dispozitat dhe kerkesat e ligjit per eficensen e energjise del e nevojshme perгатitja dhe miratimi i akteve nenligjore perkatese qe do te mundesojne zbatimin e ketij ligji. Miratimi i akteve nenligjore (per krijimin e zyrave rajonale te energjise, mbi formatet standarte te paraqitjes se te dhenave, per auditimet energjetike, per etiketimin e pajisjeve elektroshtepiake, per certifikimin e llampave elektrike, per procedurat e krijimit dhe kontrollit te fondit te eficenses) jane jo vetem nje kerkese e ligjit te mesiperm, por nga ana tjeter ato perbejne edhe nje angazhim te qeverise shqiptare ne kuadrin e MSA-se me BE-ne te perfshira edhe ne planin kombetar per zbatimin e kesaj marrveshjeje te miratuar me VKM nr.463, date 5.07.2006.

Legjislacioni i sektorit te hidrokarbureve. Legjislacioni shqiptar mund te konsiderohet i nje niveli te mire, pasi qe ne fillimet e tij ka inkurajuar dhe terhequr pjesmarrjen e investitoreve private ne kete sektor. Megjithate eshte e rendesishme qe zhvillimi ne te ardhmen i legjislacionit ne kete sektor duke patur ne konsiderate aktet dhe direktivat perkatese te BE-se dhe fokusi ne reformimin e kuadrit ligjor ne Shqiperi ne te ardhmen duhet vendosur vecanerisht ne fushat e sigurise, cilesise se produkteve dhe mbrojtjes se mjedisit dhe shendetit nga aktivitetet e ne sektorin e hidrokarbureve.

Nje ligj te ri per gazin natyror. Kuadri ligjor per gazin natyror eshte duke u ndertuar teresisht qe nga fillimi duke marre ne konsiderate legjislacionin e Bashkimit European. Sigurisht qe kjo eshte e lidhur me nje zhvillim te mundshem te tregut te ketij produkti energjetic, por duke marre parasysh zhvillimet ne sektorin energjetic ne bote ku gazi natyror po fiton nje pozicion gjithmone e me te rendesishem, futja e ketij burimi energjetic ne ekonomine shqiptare, jo vetem per prodhimin e energjise elektrike, eshte shume i afert. Ne hartimin e nje legjislacioni te tille duhet te merren ne konsiderate Direktivat e BE, te tilla si Direktiva 91/29/EC (Mbi transportin e gazit natyror neper rrjetet tranzit) dhe Direktiva 90/337/EEC (Mbi transparencen e çmimeve) si dhe Direktiva 2003/55/KE ("Direktiva e gazit").

3.2 Nxitja e Perdoritimit Eficient te Energjise

Ne kete seksion permbledhen te gjitha veprimet qe duhen ndermarre per te bere te mundur zbatimin e Strategjise Kombetare te Energjise si ne drejtim te rritjes se eficenses se energjise ashtu edhe te furnizimit me burime energjetike ne menyre te tille qe sistemi energjetic te zhvillohet ne menyre te qendrushme dhe te garantoje zhvillimin ekonomik dhe shoqeror te vendit.

Per sektorin e banesave eshte parshikuar reduktimi i nevojave per energji qe ne momentin e disenjimit te ndertesave te reja, konstruksionit te tyre duke mbajtur parasysh edhe parametrat klimaterike, permiresimeve ne eficience per stokun ekzistuese nepermjet aplikimit te termoizolimit, penetrimi i gazit te lenget LPG, penetrimi i impianteve te ngrohjes qendrore dhe asaj te perqendruar, penetrimi paneleve diellore per perгатitjen e ujit te ngrohje, perdorimi per ndrçim i llampave eficente, aplikimit te skemave dhe politikave fiskale, sistemit tarifave dhe taksave dhe permiresimit te kuadrit ligjor dhe rregullator mbeshtetes per aplikimin tyre. Si nje nga masat me efikase per reduktimin e konsumit te burimeve te energjise eshte konsideruar dhe eshte vene theksi tek promovimi dhe implementimi i masave per termoizolimin e stokut te ndërtesave ekzistuese.

Per te bere te mundur implementimin programeve konkrete per eficiencen e energjise do te jete e nevojshme krijimi i nje fondi te vecante per eficensen e energjise bazuar ne ligjin e Eficenses se Energjise te miratuar me 27 prill 2005. Ky fond mund te financohet nga te gjithë subjektet qe shesin burime energjetike ne formen e nje takse per eficensen e energjise, nga kontribute nga programet e ndryshme nderkombetare te eficiences se energjise dhe mbrojtjes se mjedisit ne kuadrin e Protokollit te Kiotos, si dhe nje pjese nga buxheti i shtetit.

Kursimi i energjise ne sektorin e industrise dhe sherbimeve parshikohet te realizohet si rezultat i nderhyrjeve ne parkun e kaldajave/furrave, duke bere te mundur zevendesimin e lendeve djegese qymyr, mazut dhe dru zjarri me solar (shkalla e penetrimit ne vitin 2020 eshte marre 25%), rritjen e faktorit te fuqise cosφ ne industri, futjen e skemave ESCO per financimin e kursimit te energjise ne industri dhe sherbime, berjen e detyrueshme te auditimeve energjitike per ndermarrjet industriale etj.

Ne sektoret e sherbimeve, industrise dhe banesave, ka nevoja energjitike ne formen e nxehtesise (ne forme avulli apo uji te ngrohete) dhe energji elektrike. Mbeshtetur ne teknologjite qe ekzistojne sot ne bote, teknologjia me eficente, e cila ben te mundur garantimin e nevojave elektrike dhe termike eshte ajo koogjeneruese, d.m.th realizimi i prodhimit te kombinuar te energjise termike dhe elektrike njekohesisht.

Investimet per kete mase do te jene private dhe nga buxheti i shtetit per ndertesat publike. Disa nga drejtimet kryesore te politikës energjitike, per te bere te mundur penetrimin ne shkalle te gjere te impianteve DH dhe SSCHP jane:

- Nxitja e instalimeve SSCHP duke shfrytezuar lehtesirat fiskale qe rrjedhin nga ligji perkates per te gjithë impiantet mbi 5 MW. AKE-ja dhe QEE-ja duhet te organizojne fushata sensibilizimi ne industri/sherbime te ndryshme per promovimin e ketyre impianteve;
- Pergatitja e legjislacionit perkates, ne menyre qe çdo teprice e energjise elektrike, qe prodhohet nga impianti SSCHP te absorbohet nga rrjeti i kompanise shperndarese elektrike (te jete nje detyrim per ta blere).

Ne sektorin e transportit disa nga masat me te rendesishme qe parashikohet te merren sipas Skenarit Aktiv jane:

- menaxhimi me i mire i sektorit te transportit;
- perdorimi i makinave me fuqi motorrike me te ulet dhe me eficiente;
- ulja e ritmit te rritjes se numrit te autoveturave;
- rritja e kontributit te transportit te pasagjereve me autobuza dhe trena;
- renia e kontributit te transportit te mallrave nepermjet perdorimit te kamionave me tonazh 3-8 ton dhe rritja e kontributit te kamionave te tonazhit 8-16 ton, mbi 16 ton dhe e transportit hekurudhor.

Ne sektorin e bujqesise disa nga masat qe parashikohen te merren sipas Skenarit Aktiv jane:

- perdorimi skemave ujtesa sa me eficiente, pra zevendesimi i ujitjes siperfaqesore qe mund te jete me brazda ose me permytje, me ujitjen me presion ne forme shiu;
- aplikimi i skemave te perdorimit te biomasave dhe prodhimi i biogazit nga mbetjet bimore dhe shtazore te bujqesise dhe blegtorise eshte gjithashtu efektiv;
- perdorimi i kolektoreve diellore qe prodhojne ajer te nxehte per tharjen e kulturave te ndryshme bujqesore;
- perdorimi i rezervuarve ekzistues te vaditjes per te instaluar impiante te gjenerimit te energjise elektrike atje ku ato jane me leverdi ekonomike;
- instalimi i 20 EEC-ve (gjeneratore ere) prane 20 hidrovoreve, qe ndodhen pergjate bregdetit Adriatik, per funksionim sa me te mire te tyre, ne sherbim te mbrojtjes se tokave nga permytjet.

Siç eshte analizuar gjate analizes se konsumit te energjise ne te gjithë sektoret, banesa, sherbime, industri, transport dhe bujqesi pothuajse ne te gjitha rastet kemi nje menaxhim jo te mire te burimeve energjitike, qe rezulton ne fund te fundit me vlera shume te rritura te

intensiteteve energjitike ne dege te ndryshme te industrise shqiptare, ne krahasim me te njejtat parametra ne vende te tjera. Bazuar ne eksperiencen boterore mund te deklarohet se vetem nepermjet nje menaxhimi me te mire, (pa nderhyrje me investime, por vetem nepermjet nje perdorimi me te mire) mund te arrihen reduktime te ndjeshme te konsumit te energjise ne nivele 10-20%.

Menaxhimi me i mire i energjise, ne pergjithesi i referohet situates kur te gjithe banoret, i gjithe personeli brenda nje ndermarrje sherbimi apo prodhimi behen vazhdimisht te ndergjegjshem, ne lidhje me koston e energjise dhe adaptojne masa (nderhyrje) te thjeshta per te bere reduktimin e saj. Kjo mase ka te beje me shume me edukimin e banoreve, perdorimi me te mire ka te beje me shume me ndergjegjesimin e personelit, dhe pak ose fare pak ka te beje me principet inxhinierike te formave te ndryshme te kursimit te energjise. Ndergjegjesimi eshte i domosdoshem te kryhet vazhdimisht per te bere te mundur “mbajtjen nen presion” te te gjithe konsumatoreve ne lidhje me manaxhimin e mire te energjise. Per te realizuar kete detyre, QEE-ja dhe AKE-ja, nepermjet nje buxheti vjetor, duhet te realizojne vazhimisht fushata te kursimit te energjise ne te gjithe sektoret e konsumit: banesa, sherbime, industri, transport, bujqesi si dhe nxitjen e shfrytezimit te burimeve te rinovueshme te energjise ne keta sektore.

Ne figuren 5 eshte paraqitur totali i kursimeve nga aplikimi i masave te eficiences ne te gjithe llojshmerine e tyre dhe ne te gjithe sektoret, i cili parashikohet qe ne vitin 2020 te arrije deri ne 1105.2 ktoe.




Fig 5.: Totali i kursimeve nga implementimi i masave te eficiences ne te gjithe sektoret [ktoe]

Persa i perket eficiences se energjise, nje rendesi te madhe do t'i jepet zbatimit te kerkesave te Ligjit per Eficiencen e Energjise te miratuar nga Parlamenti ne Prill 2005 per krijimin nga ana e Qeverise te nje Fondi te veçante i cili do te perdoret vetem per implementimin e programeve te caktuara per eficiencen e energjise dhe konservimin e saj. Ligji parashikon qe Fondi per Eficiencen e Energjise perveç fondeve vjetore nga buxheti i shtetit mund te financohet edhe nga grantet e burimeve nderkombetare financiare si dhe burimet private.

3.3 Optimizimi i Sistemit te Furnizimit dhe Rritja e Sigurise se Furnizimit me Burime Energjetike

Energjia elektrike

Per te perballuar nevojat shtese elektroenergjitike dhe per te reduktuar nivelin shume te larte te importit, ne skenarin aktiv jane konsideruar per tu identifikuar si HEC-et e reja (shiko me poshte) qe mund te ndertohen ashtu edhe TEC-et, te cilet do te mbeshtesin mbulimin e nevojave te reja shtese.

Per te investiguar nje teresi mundesish ne lidhje me pozicionin e plotesimit te nevojave per energji elektrike ne tregun e vendit tone, jane realizuar keto analiza ndjeshmerie:

- Sistemi Elektroenergjitik Shqiptar i konsideruar i izoluar dhe qe vete ploteson nevojat e tij;
- Sistemi Elektroenergjitik Shqiptar i konsideruar si nje sistem qe importon nga vendet e rajonit;
- Optimizim te perbashket te dy sistemeve, atij Kosovar dhe Shqiptar.

Ne analizen e pare te ndjeshmerise, ne zgjedhjen e centraleve te reja qe do te mbulojne ngarkesen, jane marre ne konsiderate çmimet nderkombetare te lendeve djegese te diezel marines, gazit natyror si dhe tendencat e tyre ne tregun nderkombetar. Gjithashtu ne analize jane marre ne konsiderate edhe investimet fillestare, kosto e operimit dhe shfrytezimit dhe se bashku me koston e lendeve djegese jane llogaritur kostot nje njesi te gjenerimit te njesise se energjise elektrike per secilen teknologji dhe per secilen lende djegese kur behet fjale per TEC-et. E njejta procedure eshte ndjekur edhe per vleresimin e koston njesi nga ana e HEC-eve.

Ne analizen e dyte per periudhen afatshkurter eshte patur parasysh koha e pa mjaftueshme per ndertimin e centraleve te reja, dhe eshte mbajtur ne konsiderate plotësimi i nevojave shtese gjeneruese te Shqiperise vetem nepermjet rritjes se importit. Por duhet theksuar se pavarësisht nga kjo analize skenari Aktiv udhëzon qe duke patur parasysh pasigurite ne lidhje me sasite e mundshme te importit, perkeqesimi i kushteve hidrologjike te vendit; del detyre e domosdoshme te parashikohet shtimi i kapaciteteteve gjeneruese per te rritur sigurine e furnizimit, dhe per te ulur vartesine nga importi kur kjo nuk mund te jete e mundur. Shtimi i kapaciteteteve te tjera termike, do te beje te mundur shfrytezimin me eficence te kapaciteteteve ekzistuese te HEC-eve, per te punuar ne ngarkese mesatare dhe ne pik, per plotesimin e nevojave dhe si rrjedhim per te patur nje impakt pozitiv duke lehtesuar shkembimin e energjise se pikut (pra eksportuar ne pik) dhe duke importuar energji elektrike ne baze. Per pasoje, rekomandohet qe ne terma afat shkurter te planifikohet niveli i importit dhe te punohet per venien ne pune te TEC-it te Vlores CCGT (97 MW) apo dhe te nje impianti tjetër termik. Per periudhen afatmesme-afatgjate (nga 2009 deri ne 2020) te realizohen investimet sipas masterplaneve te G/T/Sh te percaktuara per mbulimin e kerkeses se vazhdueshme ne rritje per energji elektrike dhe per te mundesuar reduktimin gradual te nivelit te importit.

Analiza e trete ajo e optimizimit te perbashket te dy sistemeve, atij Kosovar dhe Shqiptar eshte nje opsion atraktiv, qe do te mundesoje jo vetem ne funksionimin e dy sistemeve ne menyre te optimizuar si nga pikepamja e ngarkesave qe ato do te mbulojne por dhe nga pikepamja e efekteve financiare sic mund te permenden; reduktimin e koston se gjenerimit, nepermjet bashkepunimi te dy sistemeve elektrike dhe kjo kryesisht nga reduktimi i koston se lendes djegese, per shkak te qymyreve te lira ne Kosove (linjit). Per keto arsye, bashkepunimi duhet te filloje me shkembime te energjise elektrike midis Shqiperise dhe Kosoves, duke shfrytezuar kapacitetet ekzistuese te dy sistemeve dhe natyren komplementare te tyre, duke eksportuar ne pik (drejt Kosoves) dhe importuar ne baze (nga TEC-et e Kosoves). Ne keto kushte eshte e

rendesishme ndërmarrja e nje studimi te plote lidhur me zgjedhjen e menyres me te pershtatshme te bashkepunimit ne kufij te gjate kohor (sidomos pas vitit 2010), duke perfshire nje analize te opsioneve te ndertimit te TEC-eve te reja me qymyr (linjit) ne Kosove dhe ne te njeten kohe, duke instaluar me shume njesi me TEC-et me Cikel te Kombinuar me turbina me Gaz ne Shqiperi.

Eshte e qarte qe sistemi elektroenergjetik shqiptar ne periudhen afat mesme parashikohet te zhvillohet sipas opsionit te dyte. Kjo bazohet ne faktin qe opsioni i pare nuk permbush objektivin e qeverise shqiptare per sigurimin e furnizimit me energji dhe opsioni i trete kerkon nje studim te detajuar per nje zgjidhje optimale midis dy sistemeve perkatesisht sistemit elektroenergjetik shqiptar dhe atij te Kosoves.

Ne keto kushte analiza e ndertimit te veprave te prodhimit te energjise elektrike bazohet ne mundesine e furnizimit normal te konsumatoreve nepermjet gjenerimit nga veprat e vena ne shfrytezim pergjate viteve si dhe me nje import i cili mund te arrije vlerat nga 1800-2700 GWh ne vit. Vleresimet tregojne qe per periudhen afatmesme dhe afatgjate (nga viti 2008 deri 2020) jane te nevojshme kapacitete te reja shtese per normalizimin e sistemit te furnizimit. Keto kapacitete shtese mund te sigurohen me financime nga investitore private ose me financime buxhetore. Mbeshtetur ne analizen me kosto me te ulet, ecuria e ndertimit te ketyre impianteve gjenerues duhet te jete, centrali i pare 97 MW me nafte dhe gaz (CCGT) ne Vlore (ne vitin 2009). Rehabilitimi i TEC-it te Fierit deri ne fund te fund te vitit 2009 me dy faza 72 MW dhe 128 MW dhe me pas dy TEC-e te tjere te papercaktuar vendodhja te cilet duhet te ndertohen ne vitet 2011 dhe 2013, me pas do te ndertohet hidrocentrali i Devolli1 (75 MW) ne vitin 2011, hidrocentrali Vjosa 1 (80 MW) ne vitin 2010, ndertimi i HEC-it Drini1 84 MW ne vitin 2011 dhe Si perfundim, per te mbuluar kerkesen deri ne vitin 2020 kerkohen te ndertohen rreth 896 MW kapacitete te reja gjeneruese. Si fillim TEC-et ne vendin tone do te konsumojne lende djegese te lenget (diezel), pasi lidhja e vendit tone me rrjetin nderkombetar te gazit parashikohet te mundesohet vetem pas vitit 2010.

Ne kushtet e Shqiperise, zgjidhjen e furnizimit me energji elektrike ne e shohim si nje opsion shume te mundshem dhe efikas terheqjen e investitoreve private, dhe per kete ne ndertimin e HEC-eve ne lumenjte Vjosa, Devoll dhe Osum, ne sugjerojme kryerjen e studimeve te plota ne forme kaskade, te cilet te marrin parasysh jo identifikimin e optimizimit te nje centrali, por maksimalizimin e integruar te shfrytezimit te HEC-eve te mundshem ne forme kaskade te nje lumi. Eshte me rendesi te theksojme qe krahas opsioneve te mesiperme te ndërmerret Rehabilitimit i digave ekzistuese ne kaskaden e lumit Drin si nje domosdoshmëri per rritjen e sigurise dhe eficenses se hidrocentraleve te kësaj kaskase.

Masterplani i zgjerimit te rrjetit transmetues per periudhen 2006-2020.

Plani per zbatimin e masterplanit te rrjetit te transmetimit sipas projekteve te meposhteme eshte parashikuar te zhvillohet sipas ketij grafiku kohor duke u bazuar ne vleresimet e kompanise KESH, studimit te financuar nga Banka Boterore si dhe studimit te kompanise DECON.

Masterplani i zhvillimit te rrjetit transmetues eshte pergatitur ne menyre qe te mbuloje nevojat me nje kosto minimale, me nje sherbim cilesor te mjaftueshem dhe ne perputhje me kriteret e planifikimit. Mbeshtetur ne kushtin e mesiperme jane marre ne konsiderate te gjitha perforcimet e rrjetit qe rezultojne me perfitime ekonomike dhe qe plotesojne kerkesat teknike, per nje operim te sigurt te sistemit transmetues te integruar me sistemin e UCTE-se. Sistemi i transmetimit i propozuar sipas masterplanit perkates, parashikohet te arrije objektivin e humbjeve vjetore prej 2% ne vitin 2020.

Ne baze te masterplanit te transmetimit po realizohen keto projekte:

- Linja 400 kV Elbasan -Kashar- Podgorice qe parashikohet te komisionohet ne vitin 2009;

- Qendra kombetare Dispecer qe parashikohet te komisionohet ne vitin 2009;
- Nenstacioni 400/220/110 kV ne Kashar, i pajisur me dy transformatore 300 MVA, qe parashikohet te komisionohet ne vitin 2009;
- Linja dyfishe TEC i Vlores -Babice.

Projektet prioritare jane:

- Linja 400 kV Prishtine (Kosova B (ose C qe pritet te ndertohet)-Kashar qe parashikohet te komisionohet pas vitit 2010;
- Linja ndersistimore 400 kV Maqedoni-Shqiperi (Vlore)-Itali qe parashikohet te komisionohet pas vitit 2011;

Masterplani i rehabilitimit e sistemit te shperndarjes per periudhen 2006-2020.

Bazuar ne strategjine e reduktimit te humbjeve teknike, masterplani i sistemit te shperndarjes synon ne identifikimin dhe vleresimin e strategjise me te mire, per shtrirjen e rrjetit ne menyre qe ai te arrije te plotesoje nevojat ne rritje, per te gjithë kategorite e konsumatoreve. Rrjetat jane te projektuara per cdo rreth dhe masterplani i shperndarjes eshte projektuar gjithashtu per secilin rajon. Plani i rehabilitimit dhe zgjerimit eshte realizuar rast pas rasti, per te analizuar nderhyrjet e kerkuara per reduktimin e humbjeve teknike dhe plotesimin e nevojave deri ne 2020. Programi afatshkurter i investimeve per periudhen e viteve 2007-2009 perfshin:

- Vendosjen e matesave brenda vitit 2007 per te gjithë konsumatoret.
- Eleminimin e lidhjeve ilegale ne tegjitha zonat ku haset ky fenomen.
- Vazhdimi i zbatimit te projektit te Rehabilitimit te Shperndarjes.
- Ndertimi i linjave shperndarese me tension 20 kV ne disa nga qytetet kryesore te vendit.

Humbjet teknike

Aktualisht, humbjet ne sistemin e transmetimit dhe te shperndarjes jane 25.5% dhe po merren masa per reduktimin e tyre. Sic eshte theksuar gjate pershkrimin te situates elektroenergjitike, bazuar ne planin e veprimeve, per te arritur edhe ne drejtim te nivelit te reduktimit te humbjeve, jane vendosur disa objektiva per reduktimin e humbjeve. Sic edhe eshte analizuar ne studimin e Bankes Boterore, niveli i humbjeve parashikohet te reduktohet nga 25.5% ne 6% ne vitin 2020.

Struktura dhe Ecuria e Tarifave te Energjise Elektrike 2003-2020

Ne objektivin e qeverise ka nje angazhim teper serioz per te patur nje sistem eficient elektroenergjetik, ku cmimet duhet te mbulojne kostot marginale afat gjate. Tarifat e energjise elektrike sygjerojme te shkojne drejt kostos afatgjate marxhinale te G/T/SH te energjise elektrike. Ne analizen e bere ne seksionet e Masterplaneve te Gjenerimit, Transmetimit dhe Shperndarjes, jane vleresuar investimet e nevojshme, per te zbatuar keto masterplane. Mbeshtetur ne investimet kapitale per G/T/SH, kostot e operimit dhe te mirembajtjes, kostot variabel te operimit dhe te mirembajtjes, kostot e lendeve djegese si dhe kostot e importeve, llogaritet kosto marxhinale afatgjate njesi.

Mbeshtetur ne investimet e mesiperme dhe metodiken perkatese jane llogaritur kostot marxhinale per gjenerim, transmetim dhe shperndarje, te cilat jane treguar ne figuren e meposhteme. Analiza tregon, qe niveli i koston marxhinale afatgjate te G/T/SH do te jete ne vitin 2020 ne nivelin e 16 euro cent/kWh, krahasuar me strategjine e mepareshme kur kosto afat gjate marginale ishte llogaritur ne nivelin e 12 cent/kWh (niveli prej 12 cent/kWh i referohet analizet qe eshte realizuar ne Strategjine e Energjise te vitit 2003 dhe parashikimi i nevojave dhe analizat e kryera i takonin periudhes deri ne vitin 2015). Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i

ndryshimit ne rritje te çmimeve te pajisjeve ne tregun boteror, te rritjes se cmimeve te importit dhe rritjes se cmimeve te lendeve djegese. Ne figurat 6 dhe 7 jepet ecuria e krahasuese e tarifave.




Fig. 6 Tarifat e energjise elektrike sipas strgj vjeter [cent/kWh]




Fig. 7 Tarifat e en. elektr ne Startegjine e perditesuar [cent/kWh]

Hidrokarburet

Infrastruktura se importit dhe te stokimit te hidrokarbureve

Infrastruktura e tregut te karburanteve ne vendin tone paraqitet me nje numer te madh te pikave te pakices se karburanteve, ato numerohen rreth 840 te tilla, te shperndara ne territorin e vendit tone, ndersa pikat e shitjes se LPG-se jane rreth 113. Per pasoje ne te ardhmen parashikohet te behet nje optimizim i tyre ne gjithe territorin e Shqiperise bazuar ne normat dhe standartet Evropiane.

Ne Skenarin aktiv, mbeshtetet ideja e ndertimit te depozitave bregdetare te perqendruara kryesisht ne dy zona, ne ate te Vlores dhe te Porto-Romanos. Duhet theksuar qe, ndertimi i depozitave si per produktet e naftes ashtu dhe te gazit te lengshem do te jene ne perputhje te plote me normat dhe standartet teknike Evropiane per depozitat bregdetare si dhe GNL (Gazi Natyror i Lengezuar) ne zonen bregdetare te Qarkut te Fierit (zona Seman Vjose).

Sektori i rafinerise ku perfshihen dy rafinerite tona Ballshi dhe Fieri, eshte ne planet e privatizimit, sidoqofte eshte mjaft e rendesishme ndermarrja e investimeve per permiresimin e treguesve te produkteve qe ato prodhojne si dhe permiresimin e treguesve mjedisor te tyre.

Prodhimit te naftes dhe gazit deri ne vitin 2020

Prodhimi i naftes eshte i mbeshtetur ne tre variante te cilet kane ecuri te ndryshme te prodhimit, ata mbeshtetur ne analiza te ecurise normale, mbi normale dhe maksimale te prodhimit bazuar ne teknologjite e shfrytezimit te vendburimeve ranore.

Varianti 3 optimist, parashikon rezultate te sukseshme te teknologjise se nxjerrjes intensive te fluidit nga vendburimi ranor Patos-Marinz me grupe puseshe te perqendruar, qe po perdorin kompanite e huaja. Po ti referohemi grafikut, rezultatet e ketij varianti pritet te arrije 757 Ktoe ne vit per vitin 2007. Me pas parashikohet nje ritje te prodhimit te naftes deri ne vitin 2010 me

1072 Ktoe duke ruajtur nje normalitet deri ne vitin 2015 me 1080 Ktoe dhe me pas fillon zbritja e prodhimit per te arritur ne vitin 2020 ne 863 Ktoe.

Varianti 2 mbi normal, parashikon rezultatet e prodhimit duke respektuar Planin e Marreveshjes Hidrokarbure e cila parashikon prodhimin ne vitin 2007 ne 680 Ktoe ne vit, me nje maksimum ne vitin 2010 759 Ktoe dhe me pas vendburimi kontribon me renie natyrale 5 %, duke arritur prodhimin ne vitin 2015 ne 570 Ktoe dhe ne 2020 ne 403 Ktoe.

Varianti 1 me ecuri normale, rekomandohet nga Strategjia Kombetare e Energjise, parashikon nje ecuri te prodhimit te naftes si te dy variantet deri ne vitin 2006, me pas rritja e prodhimit nuk do te jete me shume se 600 Ktoe ne vit deri ne vitin 2010 per te arritur ne 488 Ktoe ne vitin 2015 dhe 344 Ktoe ne vitin 2020. Ne anizen e skenarit aktiv, kjo alternative do te merret ne konsiderate, pasi ruan nje ecuri normale te shfrytezimit te vendburimit. Prodhimi i Albpetrolit eshte marre i njejte ne te tre variantet.

Prodhimi i gazit eshte parashikuar me nje prodhim minimal bazuar nga shfrytezimi i vendburimeve ekzistuese te gazit natyror si dhe ne vendburimet e naftes sidoqofte akenari aktiv sygjeron ne te ardhmen te punohet ne keto drejtime:

- Kryerja ne 2-3 vitet e ardhshem te punimeve te pervesimit per riaktivizimin e objekteve me rezervave mbetese komerciale dhe per mundesine e aktivizimit me gaz te objekteve te rinj me karakteristika gjeofizike me te mira.
- Kryerja e punimeve per vleresimin dhe zhvillimin e vendburimit te Delvines,
- Kryerja e punimeve per perdorimin e gazit te kapelave gazore te vendburimeve te naftes, bazuar ne studimet qe rekomandojne shfrytezimin e pjeseshem te tyre.

Aplikimin e teknologjive te reja te shrytezimit te puseve per rritjen e koeficientit te gaznxerrjes ne vendburimin Cakran-Mollaj dhe aplikimin e sistemit bashkekohor te mbyllur te grumbullimit te fluideve per rritjen e koeficientit te grumbullimit te gazit. Aktualisht vendi yne ka nje prodhim minimal gazi natyror rreth 11 Milion m³N gati e paperfillshme dhe qe sherben vetem per furnizimin ne proceset e industris se naftes.

Alternativat e lidhjes se Shqiperise me Rretin Nderkombetar te Naftes dhe Gazit

Shqiperia nuk eshte e lidhur me rrjetat nderkombetare te gazit natyror dhe aktualisht ka studiuar mundesite per lidhjen e saj me rrjetin nderkombetar te gazit, ku kater alternativa jane me kryesore dhe me te mundeshme per tu realizuar te paraqitura si me poshte:

Lidhja me gazin rus nepermjet Greqise. Aktualisht tubacionet jane deri ne Selanik dhe DEPA (kompania greke e gazit) se bashku me PPC (kompania elektrike greke) nuk kane plan per gazifikimin e TEC-eve ne Follorine, gje e cila ne se do te realizohej do te shkurtonte gjatesine per tu lidhur me Shqiperine. Sidoqofte ekziston mundesia qe vendi yne te lidhet nga kjo linje duke patur parasysh idene e nje investimi grek qe lidhet me ndertimin e nje TEC-1 350 MW ne teritorin e vendit tone. Kjo linje kushton afersisht 180 MEuro se bashku me rrjetin e brendshem te gazit. Ky investim kerkon ne radhe kryerjen e studimit te plote te leverdishmerise financiare, mjedisore dhe termat teknik te projektit.

Lidhja me gazin rus nepermjet Shkupit. Kjo linje kushton me perafersi 150 MEuro se bashku me rrjetin e brendshem te gazit. Ky investim kerkon sigurimin e financimit ne radhe te pare nga ana jone dhe gjithashtu kryerjen e studimit te plote te leverdishmerise financiare, mjedisore dhe termat teknik te projektit.

Lidhja me gazin iraniano-kaspik nepermjet Tubacionit te Ri Turqi-Greqi-Itali (BOTASH-DEPA-EDISON ose i ashtuquajture tubacioni « ITG »). Duhet theksuar qe ne fillim qe ky eshte projekti me propabilitet me te larte per te gazifikuar vendin tone. Kjo linje kushton rreth 0.95 Miliard

EURO dhe do te beje te mundur transportimin e gazit Iraniano-Kaspik me nje kapacitet 12 Miliard m³N/vit. Rreth 2-2.5 Miliard m³N/vit do te konsumohen ne Greqi, nderkohe qe kerkesa e EDISONIT eshte per 8 Miliard m³N. Ne kete kuader mbeten 1-1.5 Miliard m³N/vit per tu shitur ne Itali ose konsumuar nga vendi yne ne se ne do te lidhemi me kete projekt. Stadi aktual i projektit eshte qe ai do te shfrytetoje infrastrukturen ekzistuese ne Turqi, Greqi. Nga Selaniku tubacioni do te shkoje, deri ne Igumenice (tubacion i ri per tu ndertuar) dhe pastaj nen det drejt Barit (me nje distance 225 km).

Varianti i Dyte Projekti TAP (Trans Adriatik Pipeline) Ky tubacion te kaloje nga Selaniku tranzit per ne vendin tone dhe te dale ne Vlore me avantazhin kryesor te shfrytetoje ngushticen e Otrantos (me nje distance rreth 100 km) duke zvogeluar ne kete menyre ndjeshem investimet. Per te mbeshtetur kete alternative vedi yne po shfryteton Traktatin e Komunitetit te Energjise i cili mbeshtet projektet e gazit qe gazifikojne sa me shume vende te Europes Jug-Lindore.

Projektet e Gazit Natyror te Lengezuar

Aktualisht ne vendin tone kane paraqitur interes per te investuar ne ndertimin e terminaleve te GNL tre kompani: "Trans European Energy B.V", EGL dhe ASG Power S.A., te cilat jane ne fazen e përfundimit te studimit te plote te projekteve te tyre. Qeveria Shqiptare per ka aprovuar parcelat ne zonen e Semanit ku do te ndertohen Terminalet e GNL.

Projekti AMBO

Kompania AMBO me qender ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes eshte iniciatore e projektit te naftesjellesit me gjatesi 576 milje i cili do te transportoje naften brut nga rajoni i Rusise, Azerbajxhanit, dhe Kazakistanit nga Deti i Zi ne Portin e Burgazit drejt ne Detin Adriatik. Qeverite e Shqiperise, FYROM-it dhe e Bullgarise kane garantuar AMBO-n duke i dhene te drejten ekskluzive per kete projekt i cili shihet me nje perspektive shtrirje drejt Italise nepermjet kanalit te Otrantos per te furnizuar rafinerite e medha te kesaj zone.

Deri tani midis tre shteteve fqinje ku do te kaloje ky tubacion eshte neneshkruar Memorandumi i Mirekuptimit nga Ministrat e Energjise me date.28.12.2004 ne Sofie te Bullgarise, me pas ne Tetor te vitit 2006 u firmos Memorandumi i Mirekuptimit per piken hyrese ne kufirin Shqiptaro-Madedonas dhe ne Shkurt 2007 Konventa tre paleshe nenshkruar nga Ministrat pergjegjes per Energjine te tre vendeve, Shqiperi, Bullgari dhe Maqedoni.

3.4 Nxitja e Perdorimit te Burimeve te Rinovueshme te Energjise

Bazuar ne objektin kryesor te Strategjise se Energjise qe lidhet me rritjen e sigurise se furnizimit me energji dhe objektivave te tjera specifike sic jane: reduktimi i burimeve energjetike te importuara per prodhimin e energjise elektrike dhe termike (ulja e varesise nga importi), promovimi i eficences se energjise, shfrytezimi i burimeve te rinovueshme te energjise (ne konvergjenca me direktivat e Bashkimit Europian) si dhe futja e skemave te ngrohjes se perqendruar dhe TEC-et me Cikel te Kombinuar (CHP) ne industri, sherbime dhe ne sektorin e banesave, te cilat perbejne dhe sfidat qe duhen realizuar nepermjet implementimit te kesaj Strategjie.

Veme ne dukje se nga vleresimet ne ecurine e mbulimit te nevojave energjetike per vitin 2020 kontributin kryesor do ta zene lendet djegese me 60.11 %, hidroenergjia 15.2 %, dhe nga burimet e rinovueshme te cialt parashikojne te mbulojne rreth 24.7 % nga te cilat respektivisht kontributi i seciles parashikohet respektivisht: energjia nga drute e zjarrit me 7.1 %, energjia nga TEC-et vegjel me kogjenerim 6.7 %, nga energjia diellore me 3.55 %, nga hidrocentralet e vegjel me 6.35 %, nga energjia e eres me 0.96 % dhe nga energjia gjeotermike me 0.24 %.

Per zhvillimin e burimeve te rinovueshme te energjise eshte e rendesishme te mbeshteten:

- Ndertimi i HEC-eve te vegjel;
- Hartimi i ligjit specifik per HEC-et e vegjel.mbeshtetur ne ligjin e ri te koncesioneve;
- Ndertimi i impianteve te vegjel koogjenerues, mbeshtetur ne nje analize te plote leverdishmerie financiare dhe nje analize te plote te ndikimit ne mjedis;
- Ndertimi i impianteve te vegjel te sistemeve te paneleve diellore per familjet dhe hoteleve turistik, mbeshtetur ne nje analize te plote leverdishmerie financiare dhe nje analize te plote te ndikimit ne mjedis;
- Realizimi i projektit per nxitjen e perdorimit te sobave eficente ne zonen e trete ku edhe nevojat per ngrohje jane me te medha;
- Kryerja e nje projekti studimor per matjen e shpejtesise se eres per zonat me premtuese;
- Vazhdimin e kryerjes se studimeve me te detajuara per gjetjen e sektoreve/vendeve/rajoneve/konsumatoreve ku mund te kemi zbatim me te mundshem te projekteve me qellim perftimin e energjise nga impiantet fotovoltaike, nga gjeotermia, mbetjet urbane.

3.5 Hapja e Tregut te Energjise

Hapja e tregut elektrike

Vendi yne aspiro t'i bashkohet Bashkimit Europian, dhe aderimi ne Bashkimin Europian eshte percaktuar si nje "objektiv i rendesishem kombetar" ne Dokumentin e Politikave te Sektorit Elektroenergjitik te miratuar nga Qeveria ne Prill 2002. Vendi yne eshte gjithashtu nje nga palet e procesit te Athines dhe eshte angazhuar te bashkepunoje per krijimin e nje tregu rajonal te energjise elektrike ("REM") ne Europen Juglindore. Per kete arsye perputhja me kerkesat minimale te Direktivave te aplikueshme te BE-se (ne vecanti Direktiva 2003/54/EC), me kerkesat e Traktatit te Komunitetit te Energjise te vendeve te Europes Juglindor (ECSEE Treaty) te nenshkruar ne Tetor 2005 qe eshte ratifikuar nga vendi yne, beri te nevojshme ndermarrjen e nje procesi te rendesishem per hapjen dhe konsolidimin e tregut te energjise elektrike ne vendin tone.

Ndryshimet e bera ne ligjin per sektorin e energjise elektrike me amendamentin Nr.9512 date 10.04.2006, ngarkojne Entin Rregullator te Energjise Elektrike per percaktimin e nivelit te konsumit per klientet e kualifikuar. Mbeshtetur ne kete Ligj, ne Dhjetor 2006, ERE vendosi qe niveli i konsumit per klientet e kualifikuar te ulet nga 100 GWh ne 10 GWh, te cilin e arrijne rreth 10 konsumatore te medhenj. Megjithate angazhimet e marra nga Qeveria shqiptare me nenshkrimin e Traktatit te Komunitetit te Energjise te Vendeve te Europes Juglindore, sipas te cilit duke filluar nga 1 janari 2008 te gjitha konsumatoret jo-rezidenciale do te kene te drejten te perfitojne statusin e klientit te kualifikuar, perbejne nje detyrim per pershpjtimin e hapjes se tregut me pakice.

Duke patur parasysh disa probleme, sidomos ato lidhur me paqartesite dhe mosperputhjet ne disa raste qe ekzistojne ndermjet akteve dhe dokumenteve te ndryshme te miratuara, si dhe ndryshimet e kushteve dhe te vendosmerise se Qeverise se re per te privatizuar aktivitetin e shperndarjes, u pa e nevojshme rishikimi i modelit tranzitor te tregut. Per kete qellim u krijua nje grup pune me pjesmarres nga te gjitha lojtaret e sektorit te energjise elektrike, i cili punoi i asistuar nga eksperte te USAID-it per rishikimin e ketij modeli. Nderkohe qe MTT-ja perben nje model te bazuar ne nje bleres te vetem te rregulluar, modeli i rishikuar mbeshtetet ne modelin e kontratave dypaleshe. Ndryshimi me i rendesishem me MTT-ne ne modelin e ri eshte dhenia e pergjegjesise shoqerise se shperndarjes per blerjen e energjise nga importi dhe gjeneruesit,

nderkohe qe sipas MTT-se kjo blerje behej nga OST-ja per llogari te shperndarjes.

Dy nga problemet me te rendesishme te modelit te rishikuar mbeten ato qe kane te bejne me a) vendosjen e perparise per kategorite e ndryshme te klienteve ne perfitimin nga energjia vendase hidro; dhe b) alokimit e kapaciteteve transmetuese, perfshire ato te interkonjeksionit, ne rastet kur keto kapacitete jane te kufizuara dhe nuk plotesojne kerkesat e te gjithe pjesmarresve te tregut. Nderkohe qe ceshtja e pare, eshte me shume nje ceshtje politikash energjetike dhe mund te jete objekt konsiderimi nga ana e ERE-s ne berjen e tarifave, ceshtja e alokimit te kapaciteteve te transmetimit do te jete objekt rregullimi i Rregullave te Tregut qe pritet te miratohen nga ERE-ja menjehere mbas miratimit te modelit te ri te tregut.

Drafti i Modelit te rishikuar te tregut eshte përfunduar nga grupi i punes, ne perberje te te cilit ka patur specialiste nga METE, ERE, AKE, OST dhe KESH dhe eshte ne fazen e konsultimit përfundimtar me donatoret. Pas kësaj do te ndërmerren procedurat e miratimit te këtij modeli nga Keshilli i Ministrave. Sigurisht qe rishikimi i Modelit te Tregut do te shoqerohet edhe me nje rishikim te plote te Rregullave te Tregut dhe te akteve te tjera nenligjore aktuale te miratuara nga ERE-ja, gje qe do te mundesoje implementimin e suksesshem te tij.

Tregu i naftes, gazit e produkteve te tyre

Infrastuktura e tregut te karburanteve ne vendin tone paraqitet me nje numer te madh te pikave te pakices se karburanteve, ato numerohen rreth 840 te tilla, te shperndara ne territorin e vendit tone, ndersa pikat e shitjes se LPG-se jane rreth 113. Per pasoje ne te ardhmen parashikohet te behet nje optimizim i tyre ne gjithe territorin e Shqiperise bazuar ne normat dhe standartet Evropiane. Programi i zhvillimit te sektorit te hidrokarbureve eshte perqendruar ne permiresimin e importit te produkteve te naftes ne dy zona te stokimit ne ate te Vlores dhe Porto Romanos si dhe GNL (Gazi Natyror i Lengezuar) ne zonen bregdetare te Qarkut te Fierit (zona Seman Vjose).

Transporti i produkteve te naftes per prodhimet e rafinerive te vendit dominohet nga transporti hekurudhor dhe ai rrugor, nderkohe qe per prodhimet e importuara dominohet nga transporti detar dhe me pak nga ai hekurudhor e tokesor. Kontributi aktual i transportit detar ne krahasim me ate rrugor dhe hekurudhor per produktet e importuara eshte rreth 90 % kundrejt rreth 10% qe mund te arrijne transporti rrugor dhe ai hekurudhor. Ne masat e marra nga Qeveria jone i jep prioritet transportit detar, duke patur parasysh koston me te ulet te ketij transporti, si dhe sasite e medha te transportimit qe ai kryen. Ne keto kushte me zhvillimin e investimeve per ndertimin e instalimeve detare te grumbullimit dhe manaxhimit te produkteve te naftes dhe te gazit ne Bishtin e Palles dhe ne zonen e ish-Sodes Kaustike do te marre nje zhvillim te madh transporti detar.

Pjesa me e madhe e importit te karburanteve behet nga vendet Europiane te rajonit te Mesdheut dhe Detit te Zi. Kryesisht transporti kryhet me anije e cila kohet e fundit ka nje dominim krahasuar me menytrat e tjera te transportit. Infrastuktura e transportit detar sot funksionon jo ne perputhje me kerkesat dhe standartet qe garantojne siguri te plote dhe furnizim te qendrueshem. Ne planet e zhvillimit te kesaj infrastrukture do te kete prioritet modernizimi i saj.

Ne Skenarin aktiv, mbeshtetet ideja e ndertimit te depozitave bregdetare te perqendruara kryesisht ne dy zona, ne ate te Vlores dhe te Porto-Romanos. Duhet theksuar qe, ndertimi i depozitave si per produktet e naftes ashtu dhe te gazit te lengshem do te jene ne perputhje te plote me normat dhe standartet teknike Europiane per depozitat bregdetare.

Sigurimi i nje infrastrukture eficente lidhet me faktin se tregu shqiptar i produkteve te naftes dhe gazit ka nje ecuri gjithmone ne rritje dhe sipas skenarit aktiv, ai parashikohet te arrije ne vitin 2020 nje konsum 1943 ktoe. Ne skenarin aktiv, vec masave per reduktimin e konsumit te

karburanteve, merret parasysh dhe mbrojtja e tregut, duke menaxhuar qendrat e stokimit te karburanteve si dhe sigurimin e sasise se rezeves se produkteve te naftes dhe te gazit ne normen e Bashkimit Europian. Sipas Direktives se BE (98/93/EC) kapaciteti i rezerves se sigurise duhet te mbuloj te pakten 90 dite te konsumit mesatar ditor te vitit paraardhes. Per zbatimin e kesaj direktive, eshte e nevojshme te kryhet nje studim per te dhene zgjidhje problemeve teknike, organizative, ekonomike dhe ligjore, nga zbatimi i te cilave ne nje periudhe afat mesme, te behet e mundur qe kapaciteti i rezerves se sigurise te jete ne nivelin e kerkuar ne Direktiven e BE.

Privatizimi

E gjithë reforma e ndermarre ne sektorin energjetik synon ne komercializimin e shoqerive publike qe operojne ne sektorin e energjise dhe ne zvogelimin e rolit te shtetit ne operimin e perditshem te ketyre shoqerive.

Privatizimi i sektorit te energjise elektrike

Politikat e Qeverise per sektorin elektroenergjetik, perfshire ndarjen e KESH-it, miratimi i nje modeli tregu modern per sektorin si dhe privatizimi i veprimtarise se shperndarjes do te krijojne premisat per terheqjen e investimeve nga sektori privat apo/dhe nga donatoret ne menyre qe te behet i mundur operimi mbi bazat e ekonomise se tregut, mbi bazat e parimeve te komercialitetit te kompanive OST, OSSH dhe kompanive te gjenerimit per te krijuar dhe operuar me nje sistem eficient ne menyre qe te permbushen objektivat e qeverise per rritjen e sigurise se furnizimit me nje impakt sa me minimal ne mjedis.

Privatizimi i veprimtarive te shperndarjes se KESH-it do te hape menjehere rruge per hyrjen e burimeve te reja te kapitalit, eksperiences dhe aftesive menaxheriale nderkombetare si dhe teknologjise moderne.

Ligji Nr. 8306, date 14.3.1998 "Per strategjine e privatizimit te sektoreve me rendesi te veçante" parashikon qe privatizimi i sektoreve strategjike do te realizohet me pjesemarrjen e investitoreve strategjike, te cileve u ofrohet jo me pake se 30 per qind e aksioneve dhe se kriteret e percaktimit dhe procedurat e zgjedhjes se investitoreve strategjike vendosen nga Keshilli i Ministrave. Megjithate, eshte e kuptueshme qe Qeveria do ta realizoje kete privatizim nepermjet nje procesi tenderimi nderkombetar dhe transparent. Ky lloj procesi eshte aplikuar me shume sukses nga shume vende te tjera Evropiane dhe rajoneve te tjera te botes.

Ky proces tashme ka filluar me perzgjedhjen e kompanise IFC, ne rolin e konsulentit dhe ne zgjedhjen e konsulenteve qe do te realizojne anen teknike, ligjore dhe financiare te kompanise se shperndarjes se energjise elektrike.

Privatizimi i sektorit te hidrokarbureve

Ashtu si sektori elektroenergjetik, edhe per sektorin hidrokarbur eshte punuar per privatizimin e tij, duke ndjekur drejtimet e zhvillimit strategjik ne procesin e privatizimit te prones publike. Ne vleresimin e bere per transformimin e prones publike ne sektorin hidrokarbur mendojme se pavarsisht nga specifika qe paraqesin shoqerite tregtare te veçanta te ketij sektori, per nje privatizim te sukseshem eshte e nevojshme qe ne thelb te strategjive, kuadrit ligjor dhe procedurave te privatizimit per secilen shoqeri duhet te vendoset domosdoshmeria e zhvillimit te harmonizuar te ketij sektori ne te gjithë komponentet perberes te tij dhe specifika qe e dallon ate. Privatizimi i Albpetrol sh.a. (kerkim-prodhim) duhet te dominohet nga vlere e rezervave te naftes dhe gazit qe zoteron apo administron ajo (sikurse behet per çdo kompani kerkim-prodhimi).

Privatizimi i ARMO sh.a. duhet marre ne konsiderate faktin qe rafinerite e saj jane te projektura me nje teknologji te veçante qe i pershtatet karakteristikave teper te dallueshme te naftave te

vendburimeve tona (te renda, asfalto-rreshinore e squfurore) aq me teper qe bota po i kushton vemendje te veçante nxitjes per zhvillimin dhe prodhimin e naftave jo-konvencionale. Nga ana tjeter kerkohet qe procesi i privatizimit te ARMO-s te paraprihet nga nje fushate nxitese per te terhequr interesimin e shoqerive strategjike.

4. Implikimet per burimet

Pas percaktimit te investimeve te nevojshme per kursimin e energjise skenari aktiv ka pershkruar investimet ne sektoret energjise elektrike dhe sektorit te hidrokarbureve si dy sektore qe kane peshen kryesore ne sistemin energjistik shqiptar. Ecuria e investimeve energjitike, te tilla si: sistemi i nxjerrjes se naftes, sistemi i rafinimit te naftes dhe sistemi elektroenergjitik, ben te domosdoshme realizimin e ketyre investimeve sipas Skenarit Aktiv per te bere te mundur mbulimin e nevojave energjitike. Nese krahasojme investimet ne sektorin energjetik, rezultatet parashikohen te kene nje fluks pozitiv ne Skenarin Aktiv krahasuar me Skenarin Pasiv.

